

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107*

1 E martë, 18 janar 2022

2 [Seancë e hapur]

3 [I akuzuari paraqitet përmes videolidhjes]

4 --- Seanca fillon në orën 9.30

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

6 Mirëdita.

7 Zonja Sekretare, ju lutem paraqitni lëndën.

8 SEKRETARJA E SEANCËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,  
9 mirëdita. Kjo është lënda me numër KSC-BC-2020-05, Prokurori i  
10 Specializuar kundër Salih Mustafës.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

12 Faleminderit.

13 Mirë se jeni rikthyer pas pushimit dimëror të Gjykatës.

14 Më behet qejfi që ju shoh të gjithëve të pranishëm.

15 Pikë së pari, u kërkoj palëve që të prezantohen.

16 Nga Zyra e Prokurorit të Specializuar, kush janë të  
17 pranishëm.

18 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar Gjykatës.

19 Mirëdita të gjithëve. Ekipi i Prokurorisë përfaqësohet sot nga  
20 Silvia D'Ascoli, Ndhmësprokurore; Julie Mann, Menaxhere e  
21 Lëndës; Agathe Tregarot, stazhiere e ZPS-së. Dhe unë Cezary  
22 Michalczuk, Prokuror i ZPS-së.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

24 Faleminderit.

25 Mbrojtësja e Viktimave, keni fjalën.

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107*

1 ZNJ. PUES: [Përkthim] Mirëdita, të nderuar Gjykatës.  
2 Mirëdita të gjithëve. Viktimat që marrin pjesë në këtë  
3 procedurë përfaqësohen sot nga Marie-Pier Barbeau,  
4 bashkëmbrojtëse tashmë dhe unë vetë, Anni Pues, Mbrojtëse.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
6 Faleminderit.

7 Avokati i Mbrojtjes, keni fjalën.

8 Z. VON BONE: [Përkthim] Mirëdita, e nderuar Gjykatëse.  
9 Mbrojtja përfaqësohet sot nga unë, Julius Von Bone; zoti Betim  
10 Shala, bashkëmbrojtës; hetues Fatmir Pelaj. Dhe përmes  
11 videolidhjes na bashkohet dhe zoti Mustafa.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
13 Faleminderit.

14 Zoti Mustafa, funksionon mirë lidhja? Më dëgjomi?

15 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po, zonja Gjykatëse.  
16 Mirë.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Për  
18 procesverbalin ky gjykim zhvillohet para Trupit Gjykses numër  
19 I.

20 Përpara se të fillojmë me dëshminë e dëshmitarit numër  
21 4485, zoti Fatmir Sopi, dëshiroj që të diskutoj një çështje të  
22 shkurtër me Mbrojtjen.

23 Trupi Gjykses ju rikujton se sipas paragrafit 37(e) të  
24 vendimit mbi kërkesën e Prokurorisë sipas rregullit 153 të  
25 Rregullores, që mban numrin F286, Mbrojtja u urdhërua që të

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107*

1 protokollonte një version të redaktuar publik të parashtrimit  
2 të protokolluar, me numër F278, që është përgjigje e Mbrojtjes  
3 ndaj kërkesës së Prokurorisë, brenda të mërkurës 12 janar  
4 2022.

5 Por nuk e kemi parë këtë. Keni ndonjë gjë për të thënë  
6 lidhur me këtë?

7 Z. VON BONE: [Përkthim] Nuk kemi një përgjigje.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në  
9 rregull. Atëherë do të lëshoj një urdhër gojarisht.

10 Trupi Gjykses urdhëron Mbrojtjen që të protokollojë një  
11 version të redaktuar publik të parashtrimit të protokolluar,  
12 me numër F278, sa më shpejt, por jo më vonë se dita e martë 25  
13 janar 2022.

14 Këtu mbyllet urdhri i lëshuar gojarisht.

15 Tani do të fillojmë me dëshminë e Dëshmitarit 4485.

16 Zonja Asistente e sallës, ju lutem shoqëroheni  
17 dëshmitarin të hyj në sallë.

18 [Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit]

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Uluni  
20 ju lutem, dëshmitar. Mirëdita.

21 Zoti Sopi, mirë se erdhët në Dhomat e Specializuara. Më  
22 dëgjoni

23 DËSHMITARI: Po.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Si  
25 jeni?

1 DËSHMITARI: Mirë. Faleminderit.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

3 Faleminderit.

4 Zoti Sopi, sot do të fillojmë me dëshminë tuaj. Zoti  
5 Sopi, jeni thirrur që të dëshmoni para Dhomave të  
6 Specializuara në çështjen Prokurori i Specializuar kundër  
7 Salih Mustafës në mënyrë që të ndihmoni Trupin Gjykses që të  
8 arrijë një vendim pas deklaratës solemne për të thënë të  
9 vërtetën.

10 Do t'ju bëjnë pyetje fillimisht përfaqësuesit e  
11 Prokurorisë, pastaj përfaqësuesit që përfaqësojnë viktimat që  
12 janë pranuar të marrin pjesë në procedurë, Avokati i Mbrojtjes  
13 i zotit Mustafa dhe anëtarët e Trupit Gjykses, Gjykatësit.

14 Dëshiroj që t'ju jap disa udhëzime sa u takon përgjigjeve  
15 që do t'ju jepni pyetjeve që do t'ua bëjnë.

16 Zoti Sopi, ju lutem, dëgjoheni me kujdes secilën pyetje,  
17 nëse nuk e kuptoni, lirisht mund të kërkoni që t'ua  
18 përsërisin pyetjen. Duam që të thoni të vërtetën, të na  
19 tregoni se çfarë keni parë, çfarë keni përjetuar, çfarë keni  
20 dëgjuar, çfarë keni ndjerë ju vetë. Nëse nuk e keni parë apo  
21 nëse nuk e keni dëgjuar vetë, por e keni marrë vesh në mënyra  
22 të tjera, atëherë duhet këtë ta thoni dhe të shpjegoni sesi.

23 Mund t'ju kujtohen të gjitha hollësitë e ngjarjeve, nuk  
24 ka problem për këtë. Ju lutem dëshmoni vetëm për atë që mbani  
25 mend, mos hamendësoni, mos sajoni gjëra. Nuk ka asgjë të keqe

1 të thoni që "nuk e di" apo që "nuk më kujtohet".

2 Të gjitha këto i kuptuat, zoti Sopi?

3 DËSHMITARI: Po. Po.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

5 Dëshiroj t'ju jap edhe disa këshilla praktike sa i takon

6 dëshmisë, zoti Sopi.

7 Gjithçka që themi këtu përkthehet dhe regjistrohet,  
8 prandaj është me rëndësi që të flisni afër mikrofonit, të  
9 flisni qartë dhe të flisni ngadalë që t'u jepi mundësi  
10 përkthyesve të përkthejnë gjithçka.

11 Është shumë e rëndësishme kjo që do them tani, duhet të  
12 filloni të flisni vetëm atëherë pasi të ketë mbaruar personi  
13 që po jua bën pyetjen. Prandaj mbasi të jetë bërë pyetja,  
14 numëroni me vete deri në pesë pastaj jepni një përgjigje.  
15 Sepse kjo pauzë prej pesë sekondash është shumë e rëndësishme  
16 për të gjithë ne që të dëgjojmë, të përkthejmë, të  
17 regjistrojmë ato që ju thoni.

18 Nëse keni pyetje, nëse keni nevojë për pushim apo diçka  
19 tjetër, ngrini dorën, ju lutem dhe unë do jua jap fjalën dhe  
20 mund të thoni ato që keni për të thënë.

21 I kuptuat të gjitha këto, zoti Sopi?

22 DËSHMITARI: Po.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund

24 t'i afroheni edhe pak më shumë mikrofonin zotit Sopi? Të

25 shikojmë nëse do të dëgjoheni më mirë më tutje.

1 Si me çdo dëshmitar, do t'ju kërkoj tani që të lexoni  
2 deklaratën solemne për të thënë të vërtetën. Ju rikujtoj se  
3 përbën vepër penale në kompetencën e Dhomave të Specializuara  
4 nëse jepni dëshmi të rreme.

5 Ju lutem, zonja Asistente e sallës, ndihmojeni  
6 dëshmitarin t'ia jepni deklaratën që ta lexoj.

7 DËSHMITARI: A duhet të ngritem në këmbë?

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund  
9 të qëndroni ulur, pa problem dhe të lexoni tekstin.

10 DËSHMITARI: I ndërgjegjshëm për rëndësinë e dëshmisë sime  
11 dhe përgjegjësinë time ligjore, deklaroj solemnisht se do të  
12 them të vërtetën, krejt të vërtetën dhe vetëm të vërtetën dhe  
13 nuk do të mbaj të fshehtë asgjë për të cilën kam dijeni.

14 DËSHMITARI: FATMIR SOPI

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
16 Faleminderit, zoti Sopi. Tani jeni nën betim për të thënë të  
17 vërtetën.

18 Dua t'u rikujtoj të gjithë të pranishmëve se po i  
19 zhvillojmë punimet në sesion të hapur. Nëse nuk kërkohet  
20 ndryshe nga palët apo nga Mbrojtësja e Viktimave ose nuk  
21 vendoset ndryshe nga Trupi Gjykses. Prandaj të tregojmë kujdes  
22 që të mos nxjerrim asnjë informacion me natyrë konfidenciale.  
23 Lidhur me këtë, nëse keni nevojë që të shkojmë në seancë  
24 private duhet të informoni paraprakisht Trupin Gjykses nëse  
25 këtë doni ta bëni në funksion të bërjes së pyetjeve apo të

Dëshmitari: Fatmir Sopi (Seancë e hapur)

Faqe 7

Pyetje nga z. Michalczuk

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1   parashtrimeve të tjera.

2           Tani mund të fillojmë me dëshminë e zotit Fatmir Sopi  
3   duke filluar nga pyetjet që do t'ia bëjë Zyra e Prokurorit të  
4   Specializuar.

5           Zoti Prokuror, ju keni parashikuar se ju duhen katër orë  
6   për t'i bërë pyetje këtij dëshmitari. Si zakonisht,  
7   informojeni Gjykatësin nëse do të keni ndryshime në këtë  
8   planifikim. Keni fjalën.

9           Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Patjetër, të nderuar Gjykatës.  
10   Do të përpiqemi që t'i qëndrojmë këtij vlerësimi. Nëse do të  
11   na duhet më pak kohë do t'i japim informim paraprak Trupit  
12   Gjykues.

13                           Pyetje nga zoti Michalczuk:

14   Py.   Zoti Sopi, mirëdita. Më quajnë Cezary Michalczuk. Jam  
15   Prokuror që përfaqësoj ZPS-në.

16   Pë.   [E padëgjueshme].

17   Py.   Do të bëj pyetjet nga ana e Prokurorisë sot. Gjatë këtyre  
18   pyetjeve mund t'ju tregoj edhe materiale pamore. Jeni gati që  
19   të fillojmë, zoti Sopi?

20   Pë.   Po.

21   Py.   A mundet të na thoni emrin dhe mbiemrin për  
22   procesverbalin?

23   Pë.   Unë, Fatmir Halim Sopi.

24   Py.   Pra, atësia është Halim?

25   Pë.   Halim.

1 Py. Po datëlindja juaj?

2 Pë. 13 prill 1961.

3 Py. Vendlindja.

4 Pë. Vendlindja, fshati Mramor.

5 Py. Zoti Sopi, a jeni anëtar i Organizatës së Veteranëve të

6 Luftës së UÇK-së?

7 Pë. Po.

8 Py. Çfarë pozite e mbani në atë organizatë?

9 Pë. Jam kryetar i Organizatës së Veteranëve të Luftës, dega  
10 në Prishtinë dhe anëtar i kryesisë qendrore të Organizatës së  
11 Veteranëve të Luftës në nivel Kosove.

12 Py. Që prej sa kohe e mbani këtë pozitë?

13 Pë. Kam një mandat, domethënë, që katër vite. E pesta është  
14 tash.

15 Py. A keni qenë ushtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës gjatë  
16 konfliktit të armatosur në vitin 1998 dhe 1999?

17 Pë. Po, gjatë Luftës Çlirimtare kam qenë anëtar i Ushtrisë  
18 Çlirimtare të Kosovës.

19 Py. Kur ju bashkuat Ushtrinë Çlirimtare të Kosovës?

20 Pë. Në fillimet e saj të para, unë ju kam bashkuar Ushtrinë  
21 Çlirimtare të Kosovës.

22 Py. Thatë që në fillimet e saj të para. Më specifikisht, të  
23 paktën, mund të thoni muajin dhe vitin?

24 Pë. Po fillimi i vitit 1998.

25 Py. Dhe ku ju bashkuat UÇK-së aso kohe?



1 Pë. Aso kohe ju kam bashku Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në  
2 vendlindjen time.

3 Py. A luajtët ju ndonjë rol në krijimin e ushtrisë Çlirimtare  
4 të Kosovës në zonën tuaj, në vendin tuaj?

5 Pë. Po, kam pasur rol.

6 Py. A mundet t'i tregoni Gjykatësve, shkurtimisht, se çfarë  
7 roli ishte ky?

8 Pë. Unë kam krye detyrën e organizatorit dhe shtrirjes  
9 organizative të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në regjionin e  
10 Prishtinës, më konkretisht në regjionin e Gollagut.

11 Py. Këtë rol e keni luajtur që në fillim në kyçjen tuaj në  
12 UÇK?

13 Pë. Po. Që në fillim e kam luajtur këtë rol.

14 Py. A kishte ndonjë brigadë tjetër të UÇK-së që u krijua në  
15 rajonin e Gollakut?

16 Pë. Po, kishte edhe njësi të tjera të Ushtrisë Çlirimtare të  
17 Kosovës të cilat qëndronin në Gollak.

18 Py. Pyetja ime ishte më precize me brigadë, pra, me njësi në  
19 nivelin e brigadës në regjionin e Gollakut. Pra, a kishte  
20 ndonjë brigadë që u krijua në Gollak?

21 Pë. Nuk di si mund ta quaj, por organizimet e para të Ushtri  
22 Çlirimtare e Kosovës për regjionin e Karadakut kanë fillu në  
23 Gollak. Si stacionim kanë pasë Gollakun.

24 Py. Ju vetë, a u përfshitë në krijimin e brigadës së UÇK-së  
25 në regjionin e Gollakut?

1 Pë. Cilës brigadë mendoni?

2 Pë. Çfarëdo? Cilado brigadë? Pra, a jeni përfshirë në

3 krijimin e ndonjë brigade në regjionin e Gollakut?

4 Pë. Po. Unë jam përfshirë në krijimin e Brigadës 153, e cila

5 është formu pas përfundimit të organizimit dhe të përgatitjeve

6 të duhura për plotësimin e nevojave dhe plotësimin e radhëve

7 të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës që t'a përfaqësonin

8 brigadën.

9 Py. Përmendët Brigadën 153. A mund t'u thoni Gjykatësve, se

10 kur është krijuar kjo Gjykatë [sipas përkthimit]?

11 Pë. Kjo brigadë. Po brigada, thirrjet organizative të saj i

12 ka nga njësitet tona që i kemi formu nëpër të gjitha,

13 pothuajse, nëpër të gjitha fshatrat e Gollakut dhe me

14 plotësimin e kushteve, me plotësimin e radhëve me ushtarët e

15 nevojshëm dhe kur zona operative e Llapit e ka pa të arsyeshme

16 se janë plotësu kushtet për zyrtarizimin e kësaj brigade dhe

17 themelimin e saj është caktuar, data nuk më kujtohet, në

18 shkurt të vitit 1999.

19 Py. A ndodhi ndonjë ngjarje ose a ka ndonjë ngjarje ose

20 ndonjë moment që ju kujtohet që përkon me krijimin zyrtar të

21 brigadës?

22 Pë. Po.

23 Py. A mund t'u tregoni Gjykatësve lidhur me atë ngjarje?

24 Pë. Po. Kjo ngjarje ka ndodhur në shtëpinë time, e cila

25 shërbente aso kohe si shtab i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës,

1 Brigadës 153.

2 Py. Dhe ku ndodhej shtëpia juaaj?

3 Pë. Shtëpia ime ndodhej në Zllash, një lagje e fshatit

4 Mramor.

5 Py. Pra, sapo na thatë se u krijua në shpinë tuaj ose më

6 saktë ndodhi një ngjarje në shtëpinë tuaj në shkurt të vitit

7 1999. A mund të na tregoni se çfarë ndodhi në shkurt të vitit

8 1999 në shtëpinë tuaj më saktë, që është e lidhur, pra, një

9 ngjarje e cila lidhet me krijimin e Brigadës 153?

10 Pë. Në shkurt të vitit 1999, në shtëpinë time, pikërisht në

11 vendin ku shërbente si shtabi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës

12 për Brigadën 153, erdhi, domethënë, që pritshim themelimin e

13 saj, erdhi përfaqësuesi i zonës operative të Llapit

14 zëvendëskomandanti i zonës, Kadri Kastrati, i cili bëri

15 inaugurimin solemn të Brigadës 153.

16 Py. Mund të na thoni se kush e dha urdhrin për krijimin e

17 kësaj brigade? Ishte Kadri Kastrati që vizitoi shtëpinë tuaj

18 që u erdhi në shtëpi, pra, për krijimin apo mos e urdhëroi

19 dikush tjetër?

20 Pë. Kadri Kastrati ka qenë si përfaqësues i zonës, sigurisht,

21 ka qenë i urdhëruar nga komandanti i zonës, Rustem Mustafa.

22 Py. Gjatë këtij takimi me Kadri Kastratin, kush tjetër, veç

23 jush siç kuptohet, ishte i pranishëm në shtëpinë tuaj kur ai

24 jua dha këtë porosi për krijimin e brigadës?

25 Pë. Nuk më kujtohen të gjithë personat. Më kujtohet ka qenë

1    prezent Rrahman Dini. Ka qenë prezent, nëse nuk gaboj, Sejdi

2    Veseli edhe unë. Nuk di tjetër kush ka qenë.

3    Py.   Kush u emërua komandant brigade?

4    Pë.   Komandant i brigadës në atë ditë nuk u emërua.

5    Py.   A deklaroi Kadri Kastrati se kush do të ishte komandant i

6    brigadës?

7    Pë.   Nuk deklaroj vetëm mbeti, domethënë, vend vakant, ndërsa

8    për zëvendëskomandant u emëru Sejdi Veseli.

9    Py.   Në përkthim unë e dëgjova sikur ishte Sadri Veseli. Emri

10   është Sejdi Veseli apo Sadri?

11   Pë.   Sejdi. Sejdi Veseli.

12   Py.   Faleminderit, për sqarimin.

13   Py.   Ju vetë u caktuat në ndonjë pozitë brenda kësaj brigade,

14   pra, Brigadës 153?

15   Pë.   Unë meqë merresha me organizimin e Ushtrisë Çlirimtare të

16   Kosovës në terren dhe isha vazhdimisht në terren nëpër fshatra

17   të ndryshme të Gollakut, u caktova të jem përgjegjës komandant

18   i Mbrojtjes Civile. Komandant i Mbrojtjes Civile.

19   Py.   A ishte një pozitë brenda komandës së brigadës kjo?

20   Pë.   Po.

21   Py.   Zoti Sopi, a e mbajtët ju këtë pozitë deri në fund të

22   luftës?

23   Pë.   Jo, pozitat tona kanë ndryshuar. Ne i kemi fillu si

24   ushtarë të thjeshtë. Dhe në fund të luftës, domethënë, pas

25   luftës unë kam përfundu -- kam pasë edhe pozitë të

1 zëvendëskomandantit, kam pasë në fund kur u përfundu lufta  
2 edhe pozitën e komandantit të brigadës.

3 Py. Kur u bëtë zëvendëskomandant i asaj brigade, ju kujtohet  
4 momenti, koha?

5 Pë. Me sa di unë, pas ofensivës së 18 prillit vitit 1999.

6 Py. Kush ju emëroi në pozitën e zëvendëskomandantit?

7 Pë. Në pozitën e zëvendëskomandantit, sigurisht, zona  
8 operative e Llapit, më konkretisht, komandant Rustem Mustafa.

9 Py. Na thatë gjithashtu erdhi një moment që u emëruat edhe si  
10 komandant brigade?

11 Pë. Po.

12 Py. Mund të na thoni se kur u emëruat në atë pozitë?

13 Pë. Këtë pozitë e kam mbajtur pasi që ka përfunduar lufta. Dhe  
14 kur ka fillu demobilizimi i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

15 Py. Thatë se në një moment të caktuar, pra, në prill, me sa  
16 më kujtohet, më 18 prill, u emëruat në pozitën e  
17 zëvendëskomandantit të brigadës, por më përpara na thatë që  
18 ishte Sejdi Veseli ai që e mbante atë pozitë. Pra, kur u  
19 emëruat ju si zëvendëskomandant i brigadës, çfarë u bë me  
20 Sejdi Veselin? Ndërroi pozitë?

21 Pë. Sejdi Veseli u caktua shef i shtabit të brigadës.

22 Py. Përmendët pozitën e komandantit të brigadës. E mori  
23 ndokush pozitën e komandantit gjatë luftës flasim --

24 Pë. Po.

25 Py. -- të Brigadës 153?

1 Pë. Po. Po.

2 Py. Nëse po, mund të na e thoni kush ishte ky?

3 Pë. Ky ishte Adem Shehu.

4 Py. Kush ishte Adem Shehu, domethënë, nga vinte ai? Çfarë të  
5 shkuare kishte?

6 Pë. Adem Shehu vinte nga Tirana. Kishte një eksperiencë në  
7 ushtrinë e Shqipërisë. Dhe si i tillë u emërua nga komanda e  
8 zonës operative të Llapit, komandant në brigadën tonë.

9 Py. Kur e mori pozitën e komandantit të Brigadës 153?

10 Pë. Datën e saktë nuk e di. Kjo ka ndodhë në fund të marsit  
11 të vitit 1999.

12 Py. Pra, përmendët që ju vetë, merreshit me mbrojtjen civile  
13 dhe pastaj zëvendëskomandant i brigadës. Përmendët Sejdi  
14 Veselin, që ishte fillimisht zëvendëskomandant dhe pastaj u bë  
15 shef i shtabit të brigadës dhe Adem Shehu komandant. Ju të tre  
16 ishit pjesë e komandës së brigadës; apo jo?

17 Pë. Po.

18 Py. Ishte ndokush tjetër që bënte pjesë në komandën e  
19 Brigadës 153?

20 Pë. Po, ishte dhe Rrahman Dini.

21 Py. Çfarë pozite e mbante Rrahman Dini brenda brigadës?

22 Pë. Rrahman Dini ka qenë - ka pasë pozita të ndryshme,  
23 pozitën e marrëdhënieve ushtarako-civile. Po ashtu ka kry edhe  
24 detyrën për moral dhe politik në kuadër të Brigadës 153.

25 Py. U emërua që në atë takim me Kadri Kastratin, në shkurt të

1 vitit 1999 apo u emërua më pas?

2 Pë. Mendoj se disa nga emërimet u bënë atë ditë, po nuk jam i  
3 sigurtë, ka mujt emërimet me u bë edhe më vonë. Nuk jam shumë  
4 i sigurtë. Nuk më kujtohet.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju  
6 kërkoj ndjesë, më duhet të ndalojmë për një moment sepse kemi  
7 humbur lidhjen me zotin Mustafaj. Dhe mendoj se duhet t'i  
8 kthehemi sërish asaj çfarë tha zoti Sopi sepse zoti Mustafaj  
9 nuk e dëgjoi përgjigjen e pyetjes.

10 [Vështirësi teknike]

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë.

12 Zoti Prokuror, do sugjeroja që të fillonit dhe njëherë me  
13 rreshtin 17, në faqen 13, ku bëtë pyetjen se: "Çfarë pozite  
14 kishte ai brenda brigadës?" Në mënyrë që të jemi të sigurtë që  
15 dëgjohet përgjigja.

16 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Po pa problem. E bëj me  
17 kënaqësi këtë gjë.

18 Py. Atëherë sa për zotin Mustafa, do të doja të thosha, që  
19 kjo është linja e pyetjeve që ka të bëjë me Rrahman Dinin dhe  
20 pyetja e fundit që bëra unë ishte kjo: A ishte ai, domethënë,  
21 Rrahman Dini, a u caktua në atë takim me Kadri Kastratin në  
22 shkurt të vitit 1999 apo më vonë sesa kjo kohë?

23 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Nuk e di a duhet të vazhdoj që  
24 të lexoj përgjigjen apo duhet t'i jap fjalën dëshmitarit që të  
25 japë përgjigjen?

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

2 Sugjeroj që të lexoni përgjigjen që dha dëshmitari pak më

3 parë.

4 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Atëherë përgjigja e dhënë nga

5 dëshmitari ishte si më poshtë:

6 "Unë mendoj se disa nga emërimet kanë ndodhur atë ditë,

7 por mund të ketë ndodhur që disa prej emërimeve të kenë

8 ndodhur edhe më vonë. Nuk e mbaj mend".

9 Dhe në këtë pikë neve e ndërpreme bërjen e pyetjeve.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në

11 rregull. Mund të vijoni më tej.

12 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

13 Py. Shumë faleminderit, zoti Sopi për përgjigjen e fundit të

14 dhënë. Pyetja e radhës është kjo: Në çfarë gjendje fizike

15 ishte Rrahman Dini në atë kohë në shkurt të vitit 1999?

16 Pë. Rrahman Dini në fillim ka qenë në gjendje të mirë

17 shëndetësore kur kemi punuar bashkë në organizimin e radhëve

18 të UÇK-së pothuajse në shumicën e fshatrave të Gollakut.

19 Mirëpo, ndërkohë gjendja shëndetësore e tij u keqësua. Dhe nuk

20 ka qenë në gjendje të mirë shëndetësore, domethënë, ka mesi

21 dhe përfundimi i luftës.

22 Py. A e mbani mend se kur u përkeqësua gjendja e tij

23 shëndetësore? A mund të na thoni dot ndonjë kohë?

24 Pë. Jo. Saktë nuk e di, por ai ka pasë ankesa nga pak saqë

25 dikur nuk ka mund as të veprojë.



1 Py. Çfarë natyre kishin ankesat e tij? Çfarë lloj ankesash  
2 bënte lidhur me gjendjen fizike?

3 Pë. Ka pasë probleme me frymëmarrjen, nuk ka mujt me  
4 qarkullu, me hec. Sidomos me frymëmarrjen dhe ne dyshonim se  
5 edhe zemra. Prej zemre ka pasë telashe shëndetësore për të  
6 cilat janë kujdes mjekët që i kemi pasë.

7 Py. Rrahman Dini në ndonjë kohë, në një pikë të caktuar, a ju  
8 ka thënë se cila ishte natyra e problemeve shëndetësore që  
9 kishte?

10 Pë. Unë nuk e ka ditë as ai. Nuk kam ditë as unë. Se aspektin  
11 shëndetësore veç ka pasë probleme me mushkëri, me  
12 frymëmarrjen, me zemër.

13 Py. Zoti Sopi, a e dini nëse Rrahman Dini është arrestuar  
14 ndonjëherë nga autoritet serbe?

15 Pë. Po. Po kjo ka ndodhë para lufte.

16 Py. A e dini kur ka ndodhur? Kur është arrestuar?

17 Pë. Po, e di. Në vitin 1984.

18 Py. A e dini sesa kohë ka kaluar në burg ai?

19 Pë. Katër ose pesë vite sa kam kalu edhe vetë. Ne kemi qenë  
20 bashkë në burg me Rrahman Dinin.

21 Py. A është keqtrajtuar ai gjatë kohës që është mbajtur në  
22 burg?

23 Pë. Të gjithë shqiptarët që kanë qenë të burgosur politikë në  
24 kohën kur kam qenë edhe unë edhe Rrahman Dini janë  
25 keqtrajtuar në mënyrën më çnjerëzore derisa nuk -- është

Dëshmitari: Fatmir Sopi (Seancë e hapur)

Faqe 18

Pyetje nga z. Michalczuk

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 problem me i përshkru.

2 Py. A ka pasur ndonjë dëmtim ai si rezultat i kohës që ka

3 qëndruar në burg edhe si rezultat i keqtrajttimeve,

4 maltrajttimeve që ka pësuar gjatë kohës së qëndrimit në burg?

5 Pë. Atë nuk mund ta di.

6 Py. E kuptoj.

7 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, me lejen

8 tuaj dëshiroj që të lexoj një pjesë shumë të shkurtër të

9 deklaratës së zotit Sopi lidhur me Rrahman Dinin dhe dua që të

10 përfundoj me këtë linjë pyetjesh duke lexuar këtë pjesë të

11 deklaratës së dëshmitarit edhe pastaj mund të bëjmë komente

12 dhe mund t'i bëjmë pyetje në qoftë se Dini ka për të shtuar

13 diçka apo ka për të komentuar diçka lidhur me deklaratën e

14 dhënë.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në

16 rregull.

17 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

18 Py. Zoti Sopi, do t'ju lexoj një pjesë shumë të shkurtër të

19 deklaratës që i keni dhënë Zyrës së Prokurorisë së

20 Specializuar.

21 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Për procesverbal bëhet fjalë

22 për dokumentin me numër identifikimi 069474-TR-ET, Pjesa 2,

23 faqja 5, rreshtat nga 5 deri në 10.

24 Py. Pyetja e Prokurorit që ju është bërë juve është pyetja e

25 më poshtme:

1 "Anëtarët e komandës së brigadës ishin Adem Shehu, Sejdi  
2 Veseli dhe ju vetë. Kush tjetër ishte?"

3 Dhe përgjigja që ju keni dhënë për këtë pyetje është si  
4 më poshtë.

5 "Rrahman Dini".

6 Pyetja e Prokurorit është kjo:

7 "Çfarë roli ka pasur ai?"

8 Përgjigja që ju jepni është:

9 "Ai ishte anëtar i shtabit por nuk kishte një detyrë  
10 specifike konkrete sepse ai ishte i sëmurë gjatë gjithë  
11 kohës".

12 A konfirmoni se kjo është ajo që keni thënë dhe se kjo  
13 përkon me të vërtetën?

14 Pë. Unë thashë që nuk ka pasë detyrë specifike operative,  
15 ndërsa ai me njerëz është takuar dhe e ka kry atë punën për  
16 moral politik, domethënë, në zyrat e shtabit ai ka qëndruar  
17 edhe kur ka qenë i sëmurë.

18 Z. VON BONE: [Përkthim] Nuk e di në qoftë se mund të  
19 ndërpres për një moment. Kam përshtypjen që citimi ishte në  
20 rreshtin 10 dhe në të nuk thuhet "gjatë të gjithë kohës" po  
21 "në atë kohë".

22 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Po kjo është e saktë. E lexova  
23 gabim. Po, në fakt, citimi konkret është që "Ai ishte anëtar i  
24 shtabit po nuk ishte një detyrë konkrete sepse ka qenë i  
25 sëmurë në atë kohë". Kjo është e saktë.

1 Py. Pra, zoti Sopi, ndërkohë që ju thoni se "ai ishte i  
2 sëmurë në atë kohë" e keni fjalën për kushtet që juve sapo na  
3 përshkruat sot lidhur me Rrahman Dinin; apo jo?

4 Pë. Cilat kushte mendoni, zoti Prokuror?

5 Py. Ju na thatë sot se ai kishte vështirësi në frymëmarrje  
6 dhe që dyshonit që kishte probleme me zemrën. Për këto gjendje  
7 e kemi fjalën, është e saktë kjo?

8 Pë. Po, po.

9 Py. Zoti Sopi, le të vijojmë më tej. Ku e kishte selinë  
10 Brigada 153? Sot, në një pikë, ju përmendët që shtabi ishte në  
11 shtëpinë tuaj në Zllash; a është e vërtetë kjo?

12 Pë. Po.

13 Py. A e kishte shtabin brigada në shtëpinë tuaj deri në fund  
14 të luftës?

15 Pë. Jo.

16 Py. A ka ndryshuar në ndonjë kohë shtabi dhe në qoftë se po,  
17 a mund të thoni se në çfarë vendi u vendos? Dhe sigurisht, në  
18 qoftë se është e mundur, në qoftë se mund të na e jepni kohën  
19 se kur ka ndodhur ndryshimi i shtabit të brigadës?

20 Pë. Në kushte lufte dhe në kushte të sulmeve të vazhdueshme  
21 serbe është jologjike që shtabi i brigadës të qëndrojë në një  
22 vend dhe shtabi i brigadës të jetë pikë e mundshme e sulmeve  
23 të ushtrisë dhe policisë serbe. Prandaj, shtabi i brigadës ka  
24 lëvizur prej shtëpisë sime në shtëpinë e axhit tim një kohë,  
25 disa muaj, ka mundur dy muaj. Mandej ka lëvizë në shtëpinë e

1 disa komshinjve në tjetër vend. Pasandej, ndërsa pas ofensivës  
2 serbe të 18 prillit, kur pjesa dërrmuese e shtëpive të fshatit  
3 janë djegur, shtabi i brigadës 153 ka kaluar në shtëpinë e  
4 Shaban Gashit e cila ndodhej në perëndim të fshatit Zllash.

5 Py. A mund të na thoni më konkretisht se deri në çfarë kohe  
6 ka qëndruar shtabi i brigadës në shtëpinë tuaj, domethënë, nga  
7 cila kohë deri në çfarë kohë? Për sa kohë ka qëndruar?

8 Pë. Nuk muj me ditë saktë me datë. Pas themelimit të  
9 brigadës, zyrtarët e themelimit të brigadës, që e thashë diku  
10 në shkurt të vitit 1999, kemi mund në mars të kalojmë në  
11 shtëpinë e axhës tim e cila është nja 500 metra ose 1  
12 kilometër larg shtëpisë sime.

13 Py. A ka ndonjë shkollë në Zllash? Ose për të qenë më i  
14 saktë, a ka pasur ndonjë shkollë në Zllash --

15 Pë. Po.

16 Py. -- në vitin 1999?

17 Pë. Po.

18 Py. Shtëpia e axhës tënd ishte afër shkollës?

19 Pë. Nuk është larg shkollës, por jo në shkollë, te shkolla.

20 Py. Shtabi i Brigadës 153, a ka lëvizur, a ka qenë ndonjëherë  
21 tek ndërtesa e shkollës?

22 Pë. Jo, ka qenë -- ndërtesa e shkollës ka shërbyer si qendër  
23 stërvitore. Mirëpo shtabi i brigadës e ka pasë aty komandantin  
24 e qendrës stërvitore e shumë kush e ka identifikuar se ajo ka  
25 shërbyer si shtab. Po ka qenë një zyrë e komandantit të

Dëshmitari: Fatmir Sopi (Seancë e hapur)

Faqe 22

Pyetje nga z. Michalczuk

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 stërvitjeve, e përgjegjësve që kanë qenë për stërvitje, të  
2 cilët kanë pasë zyrë dhe ka qenë kuzhina për ushtarët të cilët  
3 kanë qenë në stërvitje. Ndërsa në atë kuptimin me qenë i  
4 stacionum shtabi për kohë të gjatë në shkollë, nuk ka qenë i  
5 stacionum. Përkohësisht ne kemi qarkullu andej.

6 Py. E kuptoj. Cila ishte zona e operacioneve të Brigadës 153?  
7 Çfarë zone mbulonte Brigada 153?

8 Pë. Brigada 153 mbulonte pothuajse të gjitha fshatrat e  
9 malësisë së Gollakut, që përfshin fshatrat prej Rimanishtë,  
10 Sharban, Koliq, Nishevc, Prapashticë, Koliq, Grashticë,  
11 Dabishevc, Mramor, Marevc. Afërsisht këto fshatra.

12 Py. Zoti Sopi, mund t'i kthehemi sërish shkollës pak më vonë  
13 gjatë ditës sot, por për momentin, le të kalojmë tek një  
14 tjetër temë.

15 A jeni në dije të njësisë së UÇK-së që quhet BIA?

16 Pë. Po.

17 Py. A e dini në qoftë se ka pasur ndonjë emër tjetër kjo  
18 njësi, ky njësit, përveç BIA-s?

19 Pë. BIA ose Skifterat.

20 Py. A e dini se cili është versioni i plotë i këtij akronimi?

21 Pë. BIA është akronim i shkronjave të para të heronjve të  
22 kombit Bahri Fazliu, Ilir Konoshevci dhe Agron Rrahmani. Ky  
23 emër është marrë në shenjë nderimi të atyre heronjve.

24 Py. Ky njësit, njësiti BIA, a kishte ndonjë zonë në Zllash?

25 Pë. Po e ka pasë një vendqëndrim në Zllash.

1 Py. Dhe ky ishte ky vendqëndrimi? Ku gjendej? Ku ishte?

2 Pë. Gjendej në naltësinë më të madhe në Zllash, në veri-

3 lindje të fshatit.

4 Py. Sa larg ishte nga shtëpia juaj deri në vendqëndrimin e

5 BIA-s në Zllash?

6 Pë. Nuk jam shumë i sigurt, nja tri kilometra. Dy-tri

7 kilometra nuk -- aty dikund.

8 Py. Dhe sa kohë të duhej për të ecur nga shtëpia juaj deri

9 tek njësitit i BIA-s?

10 Pë. Mendoni në këmbë?

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Më

12 duhet t'ju ndërpresim sërish, se e humbëm sërish zotin

13 Mustafaj.

14 [Vështirësi teknike]

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zoti

16 Mustafa, na dëgjoni?

17 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Momentalisht po. Po nja

18 5 minuta, 2-3 minuta nuk ju dëgjova.

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A e

20 mbani mend gjënë e fundit që dëgjuat?

21 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Po. Ishte pyetja për

22 emnin BIA.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në

24 rregull.

25 Atëherë do t'i kërkoj, zoti Prokuror, që të lexonit

1 procesverbalin nga rreshti 9, në faqen 20, në mënyrë që ta  
2 dëgjojë zoti Mustafaj se çfarë përgjigje u dha prej  
3 dëshmitarit.

4 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Po, pa problem, e nderuar  
5 Gjykatëse.

6 Pyetja ishte kjo:

7 "A e dini se cili ishte versioni i plotë i akronimit  
8 BIA?"

9 "Pë. BIA është akronimi për germat e para të heronjve të  
10 kombit Bahri Fazliu, Ilir Konishevci dhe Agron Rrahmani. Ky  
11 emër i është vendosur brigadës si shenjë - besoj që ë shkruar  
12 një fjalë gabim këtu - por është vënë në përkujtim të këtyre  
13 heronjve".

14 "Py. Ky njësit, njësiti BIA kishte ndonjë vendqëndrim në  
15 Zllash?"

16 "Pë. Po, ato kishin një vendqëndrim në Zllash.

17 "Py. Dhe ku ishte ky vendqëndrim?"

18 "Pë. Ishte në pikën më të lartë të Zllashit në veri-  
19 lindje të fshatit.

20 "Py. Sa larg ishte shtëpia juaj nga ky vendqëndrim i BIA-  
21 s në Zllash?"

22 "Pë. Nuk jam shumë i sigurtë. Mbase dy apo tre kilometra  
23 diçka e ngjashme.

24 "Py. Dhe sa kohë duhej për të ecur në këmbë për të shkuar  
25 nga shtëpia juaj deri tek vendqëndrimi?"



1 "Pë. E ke fjalën po të shkosh në këmbë?"

2 Dhe në këtë pikë e ndërpreme me pyetjet dhe përgjigjet.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

4 Faleminderit. Mund të vazhdojmë më tej.

5 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

6 Py. Pra, kohë duhej për të shkuar në këmbë nga shtëpia juaj

7 deri në vendqëndrimin e BIA-s në Zllash?

8 Pë. 20 apo 30 minuta.

9 Py. Ne diskutuam shkurtimisht vendin ku gjendej shkolla në

10 Zllash. Sa duhej për të ecur në këmbë, sa kohë duhej për të

11 ecur në këmbë nga shkolla deri në vendqëndrimin e BIA-s në

12 Zllash?

13 Pë. 20 minuta. 15 minuta varësisht qysh ec.

14 Py. Dhe sa larg ishte shkolla nga vendqëndrimi i BIA-s në

15 Zllash në kilometra?

16 Pë. Po shtëpia ime në drejtim të shkollës nuk është asnjë 1

17 kilometër domethënë. Dhe shkolla është në mes të shtëpisë sime

18 dhe vendqëndrimit të BIA-s.

19 Py. A mund të përshkruani, ju lutem, këtë vendqëndrimin e

20 BIA-s në Zllash?

21 Pë. Shtëpi e zakonshme, një shtëpi fshatare, me oborr dhe

22 ndërtesat për banim, sikur qysh i kemi pasë edhe ne shtëpitë

23 tona. Sepse Ushtria Çlirimtare e Kosovës nuk ka pasë kazerma.

24 Ajo ka qenë e stacionuar nëpër shtëpi të qytetarëve tanë, të

25 cilët me vullnetin ma të madh na e kanë lëshu për shërbimet e

1 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

2 Py. Shtëpia, kopshti dhe ndërtesat e tjera aty të kujt ishin?

3 Kush ishte pronari i tyre?

4 Pë. Pronari i tyre ka qenë një bashkëfshatar i yni, Adem

5 Krasniqi.

6 Py. Në vitin 1999, a jetonte ai në atë kompleks?

7 Pë. Jo, ajo familje është shpërngul ma herët në Prishtinë. Jo

8 në vitin 1999, po disa vite ma herët.

9 Py. Ajo ndërtesa që ishte vendqëndrim i njësitit BIA, a mund

10 të na përshkruani pak ndërtesën, ju lutem, se thatë që ishte

11 një shtëpi e zakonshme fshati, po ne nuk e dimë sesi çfarë

12 pamje ka një shtëpi fshati. A mund të na e përshkruash pak të

13 lutem se çfarë pamje kishte kjo godina ku qëndronte

14 vendqëndrimi i BIA-s?

15 Pë. Po saktë unë nuk mund ta përshkruaj tash nga distanca.

16 Unë për vete edhe si fqinjë kam qenë si mysafir në atë shtëpi

17 para se me u shpërngul ajo familje prej aty. E di se ka pasë

18 disa shtëpi banimi. Ka pasë shtëpinë e miqve që i presin

19 miqtë, odë që i kemi thënë ne. Ka pasë pleme e cila ka shërbu

20 për ushqimin e bagëtive. Ka pasë garazha të ndryshme. Kështu.

21 Py. Pra, i keni diskutuar pak a shumë fizionominë, por

22 ndërkohë po pyes konkretisht për ndërtesën ku qëndronte BIA,

23 domethënë, çka ishte? Ishte shtëpi e miqve, odë, ndërtesë?

24 Ishte një shtëpi tjetër? Mund të jeni pak më konkret, ju

25 lutem?

1 Pë. Jo, të gjitha ato ndërtesa kanë qenë një kompleks, një  
2 oborr dhe aty ka qenë --

3 Py. A po thua që BIA ishte e pranishme në të gjithë  
4 kompleksin? Kishte të gjithë kompleksin BIA?

5 Pë. Po, atë shtëpi po. Po.

6 Py. Lidhur me kompleksin. A e mbani mend, në qoftë se  
7 kompleksi ishte i rrethuar me gardh apo jo?

8 Pë. Nuk më kujtohet.

9 Py. A e mbani mend, në qoftë se kjo shtëpi ruhej me roje?

10 Pë. Po në çdo vend ku është stacionuar Ushtria Çlirimtare e  
11 Kosovës, për sigurinë e vet ka vendos roje. Normal.

12 Py. Kush ishin rojet? A i përkisnin ndonjë njësie a njësiti  
13 të posaçëm? Ishin të njësitit BIA apo të ndonjë njësiti  
14 tjetër?

15 Pë. Jo, e kam fjalën për secila njësi ku ka pasë  
16 vendqëndrimin e caktum është siguru prej ushtarëve të vet,  
17 prej ushtarëve që kanë banu aty. Është caktu roja si  
18 zakonisht. Unë flas për pjesën ku kam organizu -- dhe organizu  
19 në atë kuptimin nëpër fshatra, nëpër vende ku kam organizu,  
20 detyra e parë e çdo njësie është që të vendosë roje. Që  
21 sigurohen ushtarët të cilët për shembull pushojnë, flenë.

22 Py. E kuptoj.

23 Këtë kompleks, ku e kishte vendqëndrimin BIA a e  
24 konsideronit si një njësi të vërtetë, si një pikë të vërtetë  
25 ushtarake?

1 Pë. Po, gjithsesi.

2 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, lidhur me  
3 pyetjen për praninë e gardhit përgjigja ishte negative. Do të  
4 doja t'ju kërkoja leje që të lexoja për dëshmitarin një  
5 fragment shumë të shkurtër të deklaratës së tij të mëparshme.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund  
7 të vijoni, zoti Prokuror.

8 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

9 Py. Zoti Sopi, a të kujtohet që ke dhënë një dëshmi për  
10 Gjykatën e UNMIK-ut, në vitin 2003?

11 Pë. Po.

12 Py. Do t'ju lexoj një pjesë shumë të shkurtër të dëshmisë që  
13 keni dhënë dhe kjo për procesverbal është, dëshmia e Fatmir  
14 Sopit, P.No.178/03, që mban datën e 29 tetorit 2003 dhe,  
15 ndërkohë, që numri ERN është 7000593 deri në 7000609RED, faqja  
16 10.

17 Prokurori publik gjatë kësaj seance në Gjykatë ju ka bërë  
18 këto pyetje:

19 "Kopshti, a ishte i rrethuar në ndonjë mënyrë?

20 Dhe pyetja kishte të bënte me këtë kompleksin e BIA-s që  
21 përshkruat ju. Përgjigja që ju keni dhënë është kjo:

22 "Jo tamam. Kishte një gardh në njërin anë, ndërkohë që në  
23 anën tjetër kishte shtëpi që ishin rreth tyre".

24 A të kujtohet se e keni thënë këtë gjë, që në të vërtetë  
25 ka pasur një gardh nga njëra anë e kompleksit, në perimetrin e

1 këtij kompleksi pra?

2 Pë. Po çdo shtëpi ka një gardh ose një pjesë të rrethume me  
3 diçka. Unë tash unë nuk jam i koncentum saktë sa huj i ka  
4 pasë, sa vende i ka pasë, ku ka qenë gardhi. Po unë thashë që  
5 nuk është -- ajo familja nuk ka qenë tuj banu aty dhe nuk i ka  
6 kushtu rëndësi që të jetë tamam i rrethum ajo komplet. Kështu  
7 që, ka muj me pasë një pjesë të gardhit. Ka mujt me u  
8 shkatërru ajo. Lufta e ka djeg krejt. Kështu që nuk është për  
9 mu -- ndoshta për juve ka rëndësi a ka pasë gardh a s'ka pasë.  
10 Po për mua nuk ka aspak rëndësi.

11 Py. Faleminderit për sqarimin. Pyetja tjetër lidhur me këtë  
12 është kjo: A e ke pasur kujtesën më të freskët sa i takon  
13 përshkrimit të ngjarjeve në 2003 apo tani, e keni më të  
14 freskët, në 2022?

15 Pë. Po nuk muj me ditë gjendjen. Nuk jam i sigurtë. Njeriu  
16 mund të harroj për një ditë po mund të mos harroj gjatë gjithë  
17 jetës diçka.

18 Py. E vërtetë. Faleminderit shumë për këtë sqarim. Ju pyeta  
19 për vendndodhjen e BIA-s. Na keni dhënë deri tani disa  
20 informacione lidhur me këtë, po a ju kujtohet nëse, brenda  
21 kompleksit në fjalë, a kishte një shtëpi në veçanti e cila  
22 ishte më e madhe se të tjerat?

23 Pë. Sigurisht më e madhe se të tjerat, thashë, ajo pjesa ku  
24 kanë jetu familja si komplet ka qenë ma e madhe. Ndërsa pjesa  
25 ku priten miqtë ka qenë, ose oda, ka qenë ma e vogël. Kështu

1 është. Me sa më kujtohet.

2 Py. Po. Ta flasim tani tek kjo shtëpia më e madhe e  
3 kompleksit. A mund të na e përshkruani këtë shtëpi nga jashtë,  
4 si dukej nga jashtë? Edhe në përgjithësi, çfarë mbani mend si  
5 ishte?

6 Pë. Nuk di si ta përshkruaj me fjalë. Shtëpi si të gjitha  
7 shtëpitë e fshatit e fshatit. Dhoma të caktume ku kanë jetu  
8 familja, ku kanë gatu, ku kanë -- rend të gjitha dhomat. Nuk  
9 di si ta përshkruaj ndryshe.

10 Py. Ishte njëkatëshe, apo dykatëshe apo trekatëshe?

11 Pë. Jo, zakonisht njëkatëshe.

12 Py. A kishte shkallë?

13 Pë. Nuk më kujtohet. Nuk më kujtohet që ka shkallë.

14 Py. Po kulmi, me se ishte e mbuluar çatia?

15 Pë. S'e di unë -- me tjegulla, me qeramidhe.

16 Py. Ju kujtohet ngjyra e këtyre tjegullave?

17 Pë. Të kuqe. Me sa di, të kuqe.

18 Py. Shtëpia ishte më vete, qëndronte veç, apo kishte dhe  
19 ndonjë ndërtesë ngjitur me atë?

20 Pë. Jo s'kam njohuri. Nuk di. Shpi a shpi.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] E

22 kemi humbur serish lidhjen por ja e kemi zotin Mustafa  
23 përsëri. Përgjithësisht më kanë informuar sot se ka probleme  
24 me internetin në Raamweg, janë probleme të përgjithshme këto,  
25 po përpiqen që ta zgjidhin. Mund të na ndodhë përsëri prandaj

1 dhe unë nuk po ja ndaj sytë ekranit ku e shohim zotin Mustafa  
2 për të shmangur që të mos flasim kur s'është i pranishëm.

3 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse, mos duhet  
4 të lexoj përsëri ndonjë pjesë, që mbase nuk e ka dëgjuar zoti  
5 Mustafa?

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ajo  
7 që pashë unë ishte, se ishin vetëm dy sekonda. Ekрани u nxi  
8 dhe u lidh përsëri. Pra, nuk ishte [se] këtu s'po thuhej  
9 ndonjë gjë gjatë këtij momenti. Kështu që mund të vazhdoni aty  
10 ku e latë.

11 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]  
12 Py. Zoti Sopi, do t'ju tregoj disa fotografi.

13 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do t'ju  
14 lutesha të nxirrni në ekran që t'i shohë zoti Sopi, të shohë  
15 një fotografi me numër ERN SPOE00128412.

16 Py. Zoti Sopi, a e shihni në ekran këtë fotografi?

17 Pë. Po.

18 Py. Fotografinë për të cilën do të diskutojmë tani. A mund të  
19 na thoni, çfarë shohim në këtë fotografi?

20 Pë. Në këtë fotografi shohim shkollën e fshatit Zllash.

21 Py. Shkolla që ju e cekët më përpara apo jo?

22 Pë. Po.

23 Py. Nëse nuk e kam gabim, përmendët diçka dhe stërvitje që  
24 organizoheshin në këtë shkollë. Domethënë, kjo është shkolla  
25 në mjediset e të cilës organizohej stërvitja?

1 Pë. Po.

2 Py. Mirë. Do t'i kthehemi pakës më vonë kësaj. A mund të na

3 thoni gjithashtu nëse ju kujtohet edhe emri i shkollës?

4 Pë. Emri i shkollës ka qenë Avni Rustemi.

5 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, kërkoj që

6 kjo foto të pranohet në prova gjyqësore. Për hir të

7 procesverbalit numri është SPOE00128412.

8 Py. Zoti Sopi, do t'ju tregoj edhe një fotografi tjetër.

9 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Për procesverbal është

10 SPOE00128388.

11 Py. Zoti Sopi, e shihni fotografinë përpara jush?

12 Pë. Po.

13 Py. Çfarë shohim në këtë fotografi?

14 Pë. Një shtëpi. Po.

15 Py. Sot para pak minutash, në fakt, diskutuam për

16 vendndodhjen e BIA-s. Kjo fotografi e tregon vendndodhjen për

17 të cilën po flisnim?

18 Pë. Po.

19 Py. Shtëpia e madhe, në anën e djathtë të fotografisë, a

20 është kjo shtëpia të cilën e përdornin ushtarët e BIA-s si

21 vendin ku qëndronin?

22 Pë. Nuk jam i sigurtë cilat pjesë i kanë shfrytëzu, qysh i

23 kanë frytëzu, nuk jam i sigurtë se nuk e kam ditë si është --

24 ku janë vendos. Nuk e kam ditë, por është pjesë e kompleksit.

25 Py. Pra, më herët sot na thatë se BIA e përdori të gjithë



Dëshmitari: Fatmir Sopi (Seancë e hapur)

Faqe 33

Pyetje nga z. Michalczuk

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 kompleksin apo jo?

2 Pë. Po.

3 Py. Pra, e kam kuptuar saktë që BIA e përdori kompleksin,

4 pra, të gjithë pjesët e atij kompleksi edhe këtë pjesë që

5 shohim në fotografi? Ju lutem, ta thoni me fjalë se lëvizjen e

6 kokës nuk e shënojmë dot në procesverbal.

7 Pë. Po, po. Po.

8 Z. VON BONE: [Përkthim] Nuk jam i sigurtë. A mund të

9 ndërhyj një moment?

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju

11 lutem, zoti avokat. Çfarë dëshironi të thoni?

12 Z. VON BONE: [Përkthim] Kuptoj se dëshmitari flet për

13 kompleksin dhe Prokurori i bën pyetje në veçanti për këtë

14 ndërtesë. Dhe në deklaratën e mëparshme dëshmitari ka thënë,

15 se ka folur për kompleksin në përgjithësi, por jo për

16 ndërtesat në veçanti të cilat shfrytëzoheshin nga njësitë BIA.

17 Kështu që unë mendoj, se në pyetjen e fundit të

18 Prokurorit, qëllimi i pyetjes, në fakt, ka për objektiv këtë

19 ndërtesë, ndërsa përgjigja e dëshmitarit është më shumë për

20 kompleksin në përgjithësi, vendndodhja që thotë ai. Po ai vetë

21 thotë që "nuk është i sigurtë se cilat ndërtesa i ka shfrytëzu

22 apo nuk i kanë shfrytëzu".

23 Kështu që unë mendoj se për të shmangur çdo ngatërrim do

24 të kërkoja që Prokuroria të përcaktojë apo të bëjë dallimin

25 midis fjalës "kompleks" dhe "ndërtesave të veçanta". Kjo është

Dëshmitari: Fatmir Sopi (Seancë e hapur)

Faqe 34

Pyetje nga z. Michalczuk

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 pyetja që unë kam për Prokurorinë, që të jetë më specifike, që  
2 ta kuptojmë a e ka fjalën për kompleksin, a e ka fjalën për  
3 ndërtesat specifike.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zoti  
5 Avokat, unë këtu e shikoj që pyetja e Prokurorit ishte:

6 "Pra, sot më herët ju thatë se BIA po e përdorte të  
7 gjithë kompleksin; a është e vërtetë?"

8 Dhe pastaj dëshmitari kësaj u përgjigj me:

9 "Po".

10 Pastaj pyetja ishte:

11 "Po a e kam kuptuar saktë se BIA po e përdorte kompleksin  
12 që shohim në fotografi?"

13 Dhe dëshmitari u përgjigj me një lëvizje pohuese të  
14 kokës.

15 Tani ju cilën pjesë doni që ta riformulojmë?

16 Z. VON BONE: [Përkthim] Nëse mund të bëjmë dallimin më  
17 shumë midis kompleksit dhe ndërtesave të veçanta që të mos  
18 flasim më në përgjithësi për të gjithë kompleksin që  
19 shfrytëzohej nga BIA. Sipas mendimit tim, dëshmitari thotë se  
20 nuk e di se cilat ndërtesa në veçanti i shfrytëzonte BIA  
21 brenda këtij kompleksi. Prandaj dhe unë do t'i lutesha kolegut  
22 tim nga Prokuroria që t'a sqarojë apo të bëjë dallimin qartë  
23 se për çfarë bëhet fjalë.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

25 Prisni pak.

1           Zoti dëshmitar, ju lutem hiqini dëgjueset nga koka.

2           Për herën tjetër, në fakt duhet ta bëjmë më përpara kur  
3 kemi çështje interpretuese.

4           Zoti Prokuror, ç'përgjigje keni?

5           Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Po kjo përgjigja ime pasqyron  
6 edhe reagimin e të nderuarve Gjykatës, në fakt, unë e kuptoj  
7 shqetësimin e kolegut tim të nderuar. Në fakt, pyetja e parë  
8 ishte ajo ishte për shtëpinë, të cilën zoti Sopi e sqaroi dhe  
9 tha që "është në kompleks". Dhe pastaj pyetja e dytë pasuese  
10 kishte të bënte për kompleksin. Ai ju përgjigj pyetjes nëse ky  
11 ishte kompleksi që shfrytëzohej nga BIA dhe ai tha "po".  
12 Prandaj për të sqaruar çështjen, e kishim fjalën për  
13 kompleksin tani.

14           KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

15           Kështu e kuptova dhe unë.

16           Do t'jua jap fjalën. Nuk e kam mbaruar frazën. Pastaj  
17 mund të flisni.

18           Do t'ju jepet mundësia. Nëse ju mendoni se nuk është  
19 sqaruar, do t'ju jepet mundësia që të bëni ju vetë pyetje  
20 lidhur me këtë. Por, mendoj se hë për hë, këto pyetje nuk  
21 ishin të paqarta.

22           Z. VON BONE: [Përkthim] Në rregull. Kjo ishte kërkesa ime  
23 nëse do të bëjmë pyetje do të flasim. Por është që duam që të  
24 kemi qartësi mbi këtë çështje, dallim midis kompleksit dhe  
25 shtëpisë. Kjo është kërkesë që unë i bëj Prokurorit.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju  
2 lutem, mund të vazhdoni, zoti Prokuror.

3 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse, do bëj  
4 çmos që të jem sa më i qartë herë tjetër për të evituar çdo  
5 paqartësi.

6 Py. Zoti dëshmitar --

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
8 Prisni një moment, ju lutem.

9 Zoti Sopi, vërinë dëgjueset, ju lutem.

10 Mund të vazhdoni.

11 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] [E padëgjueshme].

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
13 Vazhdoni, ju lutem.

14 [Përfaqësuesit e Prokurorisë këshillohen]

15 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

16 Py. Zoti Sopi, do t'ju tregoj një fotografi tjetër.

17 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Për procesverbalin kjo mban  
18 numrin SPOE00128405.

19 Py. Zoti Sopi, çfarë shohim në këto fotografi?

20 Pë. Shohim shtëpi gjysëm të shkatërrume dhe shohim një plemë.

21 Py. A është ky i njëjti kompleks që ju tregova në fotografinë  
22 që ju tregova në fotografinë më përpara?

23 Pë. Edhe kjo është në oborrin e asaj shtëpie.

24 Py. Faleminderit.

25 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Mund ta heqim këtë fotografi.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Më  
2 falni, zoti Prokuror. Dua të jem e sigurtë për numrin që u  
3 citua nga ju. A është i saktë, sepse kolegu më tha se numri  
4 është 28405?

5 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] E saktë, e nderuar Gjykatëse.  
6 Fotografia e fundit që i tregova dëshmitarit këtë numër ka.  
7 Është SPOE00128405. Kjo është fotografia e fundit.  
8 Nëse e kam thënë gabim, ju kërkoj ndjesë.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Jo,  
10 për të sqaruar. Për të qenë të qartë se mund të ketë gabim nga  
11 ana jonë. Por desha të sigurohem që është e saktë, që e kemi  
12 numrin e saktë. Faleminderit.

13 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]  
14 Py. Zoti Sopi, njësiti BIA, a bënte pjesë në Brigadën 153?

15 Pë. Jo, nuk bënte pjesë në Brigadën 153.

16 Py. Njësiti BIA, a i raportonte Brigadës 153?

17 Pë. Jo.

18 Py. Kujt i raportonte njësiti BIA atëherë?

19 Pë. Unë nuk kam qenë përgjegjës kush, kujt i raporton. Mirëpo  
20 në bazë të organogramit të zonës operative të Llapit e kam  
21 vërejt se një, domethënë, njësiti BIA ju kanë përgjigj zonës  
22 operative të Llapit, komandës së zonës operative të Llapit.

23 Py. [E padëgjueshme] Kjo organigram e zonës operative të  
24 Llapit që ju sapo e përmendët, çfarë ishte kjo organigramë?

25 Pë. Struktura e zonës operative të Llapit. Struktura.

1 Py. Kush e përgatiti atë organigram?

2 Pë. Shtabi i zonës operative të Llapit sigurisht.

3 Py. A e dini se kush ishte komandant i njësitit BIA?

4 Pë. Po.

5 Py. Kush ishte komandant?

6 Pë. Sali Mustafa.

7 Py. A kishte ndonjë nofkë?

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Më  
9 falni zoti Prokuror, se përsëri nuk e kemi zotin Mustafa në  
10 lidhje. Kemi dhe 10 minuta. Po i afrohem pushimit, pra, që  
11 është ora 11.00.

12 [Vështirësi teknike]

13 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, unë kam  
14 shumë pyetje lidhur me këtë pistë pyetjesh. Kështu deri në ora  
15 11.00 unë këtë pjesë e mbaroj dhe pastaj rifillojmë.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
17 Faleminderit. Propozoj që ta rifilloni pyetjen se kush ishte  
18 komandant i njësitit BIA, Këtu u bë ndërprerja e lidhjes.

19 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Patjetër, e nderuar Gjykatëse.

20 Pyetja që Prokurori bëri ishte:

21 "A e dini kush ishte komandant i njësitit BIA?"

22 Përgjigja ishte:

23 "Po".

24 Pyetje:

25 "Kush ishte atëherë komandanti?"

1 Përgjigje:

2 "Sali Mustafa".

3 Dhe pyetja ime e fundit e cila nuk mori përgjigje ende  
4 është:

5 "A kishte ndonjë nofkë?"

6 Pë. Po.

7 Py. Cila ishte kjo nofkë e Sali Mustafës?

8 Pë. Ne e kemi njoftë edhe si Cali.

9 Py. A e dini se çfarë roli kishte njësitit BIA?

10 Pë. Njësitit BIA kishte rol si të gjitha njësitet e Ushtrisë  
11 Çlirimtare të Kosovës çlirimin e vendit nga pushtuesit serb.

12 Py. Këtë e kuptoj. Dhe ajo që thatë është e vërtetë, por a  
13 mund t'u thoni Gjykatësve se cili ishte roli më specifik i  
14 njësitit BIA brenda UÇK-së?

15 Pë. Rolin më specifik të njësitit BIA ma së miri e shpjegon  
16 vetë përfaqësuesi i njësitit BIA besoj. Ndërsa unë sa kam  
17 mujtë me kuptu ka qenë pjesë e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës  
18 sikur të gjitha njësitet e tjera në zonën operative të Llapit.

19 Py. E kuptoj që anëtarët e atij njësitit mund ta shpjegonin më  
20 mirë se ishin anëtarë aty, po pyetja ime ishte, po ju vetë  
21 çfarë dini sa i takon rolit që luante BIA brenda Ushtrisë  
22 Çlirimtare të Kosovës?

23 Pë. Saktë rolin e çdo ushtari dhe njësie unë nuk mund ta di,  
24 por e di që kanë punu në bazë të urdhrave dhe në bazë

25 rrethanave të kohës që të japin kontributin e tyre të çmuar

1 për çlirimin e vendit.

2 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] [E padëgjueshme] Kërkoj ndjesë  
3 për mikrofonin sepse e fik vetë dhe e ndez herë pas here.

4 A mund t'i lexoj dëshmitarit një pjesë shumë të shkurtër  
5 që i ka dhënë -- të deklaratës që ai i ka dhënë ZPS-së sa i  
6 takon rolit që ka luajtur njësitit BIA mbasi ia rifreskon  
7 kujtesën.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po.

9 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Faleminderit.  
10 Py. Zoti Sopi, do ju lexoj një pjesë shumë të shkurtër të  
11 deklaratës që i keni dhënë ZPS-së.

12 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Për procesverbalin është me  
13 numër ERN 069474-TR-ET, pjesa 2, faqja 16, rreshtat nga 21  
14 deri në 24.

15 Py. Pyetja ka qenë pikërisht për këtë. Për rolin e BIA-s dhe  
16 përgjigja jua j aty ka qenë është që:

17 "Nuk ka pasur një numër të caktuar sepse detyrat kanë  
18 qenë për të mbikëqyrur dhe për të parë Prishtinën."

19 Pra, pyetja është: Pyetja ishte:

20 "Për të parë, për të vëzhguar çfarë?

21 Përgjigja:

22 "Situatën. Lëvizjet".

23 A e konfirmoni që një pjesë e rolit të BIA-s ishte të  
24 mbante nën vëzhgim lëvizjet në Prishtinë?

25 Pë. Po, e konfirmoj se pjesë e detyrës së secilit ushtar të



1 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës ka qenë që të vëzhgojnë  
2 lëvizjet e armikut, lëvizjet e ndryshme të armikut që kanë  
3 mund të rrezikojnë popullatën e shumtë që ndodhej në atë kohë  
4 në Gollak dhe kështu kemi vjelë informata të vlefshme për  
5 lëvizjet eventuale të armikut në drejtim të pozicioneve të  
6 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës dhe të popullatës civile. Në  
7 atë kohë në Gollak ishte në një numër shumë të madh me mijëra  
8 e mijëra vetë të cilët soldateska serbe i kishte përzënë prej  
9 shtëpive të tyre në Prishtinë dhe në drejtim -- të cilët i  
10 kishte përzënë në drejtim të fshatrave të Gollakut, po ashtu  
11 një pjesë të fshatrave dhe të qytetit të Podujevës.

12 Kështu që, ne kemi qenë të interesuar që t'i dimë  
13 lëvizjet eventuale të ushtrisë dhe policisë serbe që të mos  
14 kemi humbje të mëdha në radhët e popullatës civile. Dhe çdo  
15 informatë e vlefshme që do të vinte për lëvizjet eventuale të  
16 armikut do të ishte e mirë se ardhun për përgatitjen tonë për  
17 mbrojtje.

18 Py. Pra, nga ajo që thatë ju edhe BIA ishte e angazhuar në  
19 vjeljen e këtyre informatave; kështu?

20 Pë. Po. Po.

21 Py. Zoti Sopi, do t'ju lexoj një pjesë tjetër shumë, shumë të  
22 shkurtër të deklaratës suaj të cilën ja keni dhënë Gjykatësit  
23 Hetues. E kam fjalën për dokumentin që quhet procesverbal i  
24 redaktuar i seancës gjykimore me dëshmitarin, Dëshmitari  
25 004485, me numër ERN 700069 deri në 700676RED 1, faqe 3.

1 Py. Zoti Sopi, ka kaluar shumë kohë e gjatë që ju e keni  
2 dhënë këtë deklaratë, po kjo ka qenë ajo që i keni thënë  
3 gjykatësit në rastin e Agron Zeqirit. Pyetja që ju bëri  
4 gjykatësi hetues ishte kjo:

5 "A dini diçka lidhur me një organizatë që quhet BIA?

6 Përgjigja juaj ishte:

7 "Po, e di vetëm që ishte një njësit në zonën operative të  
8 Llapit që merrej, se këtu nuk jam këtu që të flas për  
9 aktivitete të të tjerëve, por që përdorej për të ofruar  
10 logjistikën për zonën operative të Llapit. Të gjente ushqime,  
11 infermiere dhe mallra mjekësore".

12 A ju kujtohet që ia keni thënë këtë gjykatësit hetues dhe  
13 a është e vërtetë që këtë dijeni keni pasur?

14 Pë. Po, ia kam thënë gjykatësit hetues. E them prapë edhe ato  
15 detyra njësiti gueril BIA i ka kry dhe ka qenë si furnizues  
16 edhe për zonën operative të Llapit edhe për njësi të tjera të  
17 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Dhe në situata të ndryshme,  
18 kur e ka lyp nevoja, ka marrë pjesë edhe në beteja të cilat  
19 janë përballë njësite të tjera të Ushtrisë Çlirimtare të  
20 Kosovës, qoftë të Brigadës 153, qoftë edhe të brigadave tjera  
21 kur ka pasë nevojë, kanë marrë pjesë edhe në beteja dhe në  
22 luftime.

23 Py. Mbase dhe pyetja e fundit përpara se të bëjmë pushimin.

24 Zoti Sopi, njësiti BIA ku ushtronte aktivitetet? Ku?

25 Pë. Nuk kam informata ku saktësisht ku shtronte aktivitetet.

Dëshmitari: Fatmir Sopi (Seancë e hapur)

Faqe 43

Pyetje nga z. Michalczuk

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 Nuk kam informata. Nuk di.

2 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] E nderuar Gjykatëse, me lejen  
3 tuaj dhe kjo është hera e fundit që po e përmend deklaratën e  
4 dëshmitarit që ia ka dhënë ZPS-së, dua që t'ia lexoj  
5 dëshmitarit me një pyetje të cilën mund ta konfirmojë ose ta  
6 mohojë. Numri është 069474-TR-ET, pjesa 2, faqja 16, rreshtat  
7 nga 21 deri në 24.

8 Py. Pyetja e Prokurorit ishte:

9 "Ku ushtronte aktivitetet ai njësit?" Pra, që është BIA.

10 Përgjigja që i keni dhënë kësaj pyetjeje ishte:

11 "Nuk është që kishte një numër të përcaktuar" dhe e keni  
12 fjalën për numrin e anëtarëve të BIA-s.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Më  
14 falni zoti Prokuror, që ju ndërpres por dua të sigurohem. Ju  
15 thoni pjesa 2, faqja 16. A është e njëjta që keni cituar më  
16 përpara për lëvizjet, lëvizjet e armikut për të cilat foli  
17 dëshmitari?

18 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Për të qenë i saktë të  
19 konsultohem me kolegen, pastaj mund të rifilloj.

20 [Përfaqësuesit e Prokurorisë këshillohen]

21 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, propozoj  
22 të bëjmë pushimin dhe gjatë kësaj kohe vlerësojmë nëse do jetë  
23 e nevojshme apo jo t'i bëj ato pyetje që i kisha në mendje apo  
24 jo.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] [E

Dëshmitari: Fatmir Sopi (Seancë e hapur)

Faqe 44

Pyetje nga z. Michalczuk

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 padëgjueshme]. Faleminderit shumë, zoti Prokuror.

2 Zonja asistente e sallës, ju lutem shoqërohëni  
3 dëshmitarin të dalë nga salla. Do të bëjmë këtu pushimin, zoti  
4 Sopi. Do bëjmë pushim 30 minuta tani dhe do të riktheheni këtu  
5 në sallë kur të rifillojmë. Në rregull?

6 DËSHMITARI: Faleminderit.

7 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

9 Faleminderit.

10 Përpara se ta ndërpresim këtë sesion, duke qenë se jemi  
11 në seancë publike, pala që bën pyetje mund ta mbajë mikrofonin  
12 hapur, më kanë thënë, se nuk ka probleme për arsye sigurie apo  
13 të mbrojtjes. Kështu që kjo mund të na ndihmojë të gjithëve.

14 Këtu bëjmë ndërprerjen. Do të rishihemi pas 30 minutash.

15 --- Pauza fillon në orën 11.03

16 --- Seanca rifillon në orën 11:32

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju

18 lutem uluni.

19 Le të fillojmë me praninë e ZPS-së, me çfarë shoh nuk  
20 kemi ndonjë ndryshim apo jo?

21 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Jo, nuk kemi asnjë ndryshim, të  
22 nderuar Gjykatës.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nuk

24 ka ndryshime as për avokaten e viktimave?

25 ZNJ. PUES: [Përkthim] Jo.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po,  
2 zoti Von Bone, ndonjë ndryshim nga ana juaj?

3 Z. VON BONE: [Përkthim] Jo, nuk kemi as ne asnjë  
4 ndryshim.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zonja  
6 Sekretare, ju lutem mund të sillni dëshmitarin në sallën e  
7 gjyqit.

8 [Dëshmitari hyn në sallën e gjyqit]

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju  
10 lutem uluni.

11 Mirë se erdhët sërish, zoti Sopi.

12 Zoti Prokuror, mund të vazhdoni me pyetjet.

13 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

14 Py. Zoti Sopi, mirë se erdhët përsëri.

15 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, mbase unë  
16 nuk do të përdor të gjithë ditën sot. Mund të ndodhë që të  
17 përfundojmë deri në pushimin e drekës ose mund të ndodhë që të  
18 vijojmë edhe pak pas pushimit të drekës. Kjo është thjesht për  
19 t'ju njoftuar sa i takon kohës që do të përdorim për marrjen  
20 në pyetje të dëshmitarit.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë  
22 faleminderit. informacion i dobishëm.

23 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

24 Py. Zoti Sopi, dëshiroj ta ndryshoj paksa fushën e pyetjeve  
25 të mia. Sot m'u përpara pushimit të kafes, ne përmendëm

1 shkollën dhe diskutuam shkurtimisht për shkollën në Zllash. Ju  
2 gjithashtu përmendët stërvitjen dhe duke ju kthyer sërish  
3 temës së stërvitjes, a e kam kuptuar drejtë që në shkollën në  
4 Zllash organizoheshin stërvitje? Është kështu apo jo?

5 Pë. Po, e vërtetë është.

6 Py. A mund të më thoni ju lutem, diçka lidhur me këtë  
7 stërvitje. Si organizoheshin këto stërvitje?

8 Pë. Këto stërvitje organizoheshin me grupe të luftëtarëve ose  
9 të vullnetarëve, nga njësite të cilët ishin formuar më parë  
10 nëpër fshatra të ndryshme të Gollakut, dhe varësisht prej  
11 nevojave dhe sipas rendit -- për shembull njësitet e caktuara  
12 në një fshat të caktuar prej 20 - 30 vetave, organizoheshin  
13 dhe vinin në shkollën e Zllashit për stërvitje ushtarake  
14 bazike. Ato të nevojshme që do t'ju shërbenin për beteja të  
15 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës karshi forcave serbe.

16 Py. Për sa kohë zgjaste stërvitja për ato grupe njerëzish që  
17 vinin në Zllash për t'u stërvitur?

18 Pë. Nuk jam shumë i sigurt. Ka ndodhur tre javë, deri në 4  
19 javë. Varet prej -- s'po di saktë. Nuk jam shumë i saktë se ka  
20 kaluar kohë e gjatë, por afërsisht deri sa e kanë përvetësuar  
21 gjërat elementare që ju janë dashur ushtarëve që t'i  
22 përvetësojnë.

23 Py. Çfarë përmbante stërvitja, cilët ishin elementët ose  
24 cilat ishin pjesët përbërëse të stërvitjes?

25 Pë. Elementët e stërvitjes ishin përgatitja e tyre fizike,

1 prova të përgatitjeve fizike. Ishin njoftime dhe demonstrime  
2 të armëve që posedonin, si dhe stërvitje të tjera. Për  
3 shembull për beteja, forma strategjike, për shembull të  
4 gjendjes së tyre gjatë operacioneve të luftës.

5 Py. Stërvitjet për të cilat po flasim, organizoheshin për ata  
6 që ishin ushtarë të UÇK-së apo organizoheshin për rekrutët e  
7 rinj, për ata që donin të bëheshin pjesë e UÇK-së.

8 Pë. Po zakonisht, njëherë ata rekrutoheshin në fshatrat e  
9 tyre dhe për t'u përgatitur për luftë, vinin ata që nuk kishin  
10 kryer ushtrinë jugosllave -- sepse një pjesë e madhe e  
11 luftëtarëve tanë e ka pas kryer ushtrinë jugosllave dhe kanë  
12 pasur njohuri bazike dhe nuk kanë pasur nevojë që të marrin  
13 pjesë në stërvitje shtesë. Por e kam fjalën për ata rekrutët e  
14 rinj, të cilët kanë qenë në numër të shumtë që janë paraqitur  
15 vullnetarë dhe kanë dashur të marrin përvojën bazike për  
16 përgatitjen për luftë.

17 Py. Ju thatë që ata vinin nga fshatrat e tyre. A ishin  
18 regjistruar ata më përpara në fshatrat e tyre ose a kishte  
19 ndonjë sistem që bënte regjistrimin e tyre brenda shkollës?

20 Pë. Jo, në fshatrat e tyre ata ishin të regjistruar dhe vinin  
21 në grup, të cilët i kishin dërguar komandantët e njësive të  
22 tyre. Domethënë të fshatrave.

23 Py. Gjatë stërvitjes, këta rekrutët e rinj, a ju jepej atyre  
24 uniformë?

25 Pë. Nuk ka pasur uniforma të mjaftueshme. Nuk ka pasur

1 uniforma të mjaftueshme. Ka ndodhur që i është dhënë dikujt  
2 ndonjë uniformë, por nuk -- pjesa dërmuese, domethënë, nuk ka  
3 pasur uniforma. Por kanë ardhur edhe civilë. Një pjesë ka  
4 pasur uniforma, domethënë -- se kemi pasur mungesë të  
5 uniformave, nuk kemi pasur për krejt ushtarët uniforma kurrë.

6 Py. Gjatë stërvitjes, rekrutëve a ju jepeshin armë?

7 Pë. Zakonisht kanë qenë të përgatitura armë, sa ka nevojë për  
8 rekrutët gjatë kohës sa kanë qëndruar në qendrën e  
9 stërvitjeve.

10 Py. Pra --

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zoti  
12 Prokuror, ju kërkoj ndjesë por kemi humbur zotin Mustafa,  
13 kështu që duhet të presim një moment që të rilidhet zoti  
14 Mustafa.

15 [Vështirësi teknike]

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zoti  
17 Mustafa, mirë se u kthyet. A e dëgjuat përgjigjen në lidhje me  
18 armët, zoti Mustafa?

19 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Jo. Kam dëgjuar deri te  
20 pyetja për stërvitjet.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po  
22 për uniformat a e dëgjuat pyetjen? Pra a e dëgjuat në qoftë se  
23 rekrutëve të rinj ju jepeshin uniforma apo jo?

24 I AKUZUARI: [Përmes videolidhjes] Jo, nuk e kam dëgjuar.

25 Domethënë unë e kam dëgjuar deri -- deri kur ka filluar



1 Fatmiri me sqaru njësitet që kanë ardhur pej fshatrave në  
2 trajnime në shkollë.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju  
4 lutem a mund të lexoni që prej kësaj pike e në vijim, zoti  
5 Prokuror? Mendoj që jemi në faqen 43.

6 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Po, mund të filloj me faqen 43.  
7 Pyetja e parë që iu bë në këtë faqe ishte:

8 "Për sa kohë zgjaste stërvitja për grupet e njerëzve që  
9 vinin në Zllash për t'u trajnuar, për t'u stërvitur"?

10 Përgjigja ishte:

11 "Nuk jam shumë i sigurt por ndoshta 3 tre javë, deri në  
12 katër javë. Nuk mund të jem shumë i saktë sepse ka kaluar  
13 shumë kohë. Por deri sa ata zotëronin njohuritë e nevojshme  
14 për ushtarëve, ata trajnoheshin, për stërviteshin."

15 Pyetja tjetër ishte:

16 "Në çfarë përbëhej stërvitja, cilat ishin elementët ose  
17 cilat ishin pjesët përbërëse të stërvitjes?"

18 Përgjigja është kjo:

19 "Elementët e trajnimit ishin që ishte trajnim fizik,  
20 demonstrim i armëve që ata zotëronin, dhe kishte edhe forma të  
21 tjera të trajnimit për luftëra, format strategjike gjatë  
22 operacioneve."

23 Pyetje:

24 "Stërvitjet për të cilat po flasim, a organizoheshin për  
25 ata të cilët ishin anëtarë ose ushtarë të UÇK-së apo

1 organizoheshin për rekrutët e rinj që dëshironin të bëheshin  
2 pjesë e UÇK-së?"

3 Përgjigje:

4 "Zakonisht ata rekrutoheshin në fshatrat e tyre dhe më  
5 pas, për t'u përgatitur për luftë, ata vinin atje. Ata që nuk  
6 e kishin kryer ushtarak -- sepse faktikisht një numër i  
7 konsiderueshëm luftëtarësh e kishin kaluar shërbimin ushtarak  
8 të ushtrisë jugosllave dhe ata nuk kishin nevojë që të  
9 trajnoheshin apo të stërviteshin më tej. Por e kam fjalën për  
10 rekrutët e rinj, të cilët vinin në numra të mëdhenj si  
11 vullnetarë, dhe dëshironin që të merrnin njohuritë bazë për  
12 luftën".

13 Pyetje:

14 "Ju thatë që ata vinin nga fshatrat e tyre. A ishin  
15 regjistruar ata në fshatrat e tyre apo kishte ndonjë sistem  
16 regjistrimi që ekzistonte në shkollë për ta"?

17 Përgjigje:

18 "Jo, ata ishin të regjistruar në fshatrat e tyre përkatës.  
19 Dhe vinin në grupe, të dërguar nga komandantët e njësiteve,  
20 komandantët përkatës të njësiteve të tyre.

21 "Pyetje: Gjatë stërvitjes, këta rekrutë të rinj, a ju  
22 jepej atyre uniformë?"

23 Përgjigje:

24 "Jo, ne nuk është se kishim uniforma të mjaftueshme. Pra,  
25 mund të ndodhte që dikujt t'i jepej një uniformë, por pjesa

1 dërmuese nuk kishte uniforma. Një pjesë e tyre kishin  
2 uniforma, por siç e thashë edhe më përpara, ne nuk kishim  
3 uniforma të mjaftueshme. Nuk mund t'u jepnin uniforma të  
4 gjithë ushtarëve."

5 Pyetje:

6 E kuptoj. Gjatë stërvitjes, rekrutëve a u jepeshin armë?"

7 Përgjigje:

8 "Zakonisht kishim armë, kishim armë të mjaftueshme për  
9 t'ua dhënë rekrutëve për aq kohë sa ata ishin të pranishëm në  
10 vendin e stërvitjes."

11 Dhe ky është fundi i kësaj pjese.

12 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

13 Faleminderit, zoti Prokuror, faleminderit që e lexuat  
14 edhe një herë këtë pjesën e segmentit që nuk e dëgjoi  
15 zoti Mustafa.

16 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

17 Py. Zoti Sopi, po flasim sërish për stërvitje. Ku qëndronin,  
18 ku flinin ata që stërviteshin në Zllash?

19 Pë. Në objektin e shkollës së Zllashit.

20 Py. Stërvitja për këta rekrutë të rinj organizohej jashtë?

21 Brenda godinës, ndërtesës, në të dyja ambientet, edhe jashtë  
22 edhe brenda?

23 Pë. Edhe jashtë edhe brenda. Pjesa fizike, e përgatitjes  
24 fizike zakonisht bëhej në terrene malore, jashtë, ndërsa pjesa  
25 teorike dhe demonstrimi i armatimit dhe pjesa teorike mbahej

1 edhe brenda.

2 Py. Kur thoni "brenda", e ke fjalën për brenda ambienteve të  
3 shkollës në Zllash?

4 Pë. Ka mund në shkollë brenda, ka mund në oborr të shkollës.

5 Py. Kush i ofronte stërvitje këtyre rekrutëve të rinj në  
6 Zllash?

7 Pë. Stërvitje fizike, domethënë përgatitjen fizike, e ka  
8 përgatitur Musli Halimi, një ushtar me emrin Musli Halimi.  
9 Ndërsa njohjen me armë dhe me pjesën teorike, Bexhet Vitia dhe  
10 Emin Borovici.

11 Py. Dua të flasim për një moment lidhur me Brigadën 153.

12 Pyetja e parë që kam lidhur me këtë temë është kjo: çfarë  
13 strukture kishte kjo Brigadë ose për të qenë më konkret, a  
14 kishte batalione, kompani, toga kjo brigadë në përbërjen e  
15 saj?

16 Pë. Në fillim ne e kemi quajtur njësi ushtarake ose njësite.  
17 Mirëpo më vonë, pasi themelimit ose zyrtarizimit të Brigadës,  
18 e kemi ndarë në batalione.

19 Py. [E padëgjueshme].

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

21 Mikrofonin ju lutem.

22 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

23 Py. Në çfarë kohe është bërë një ndarje e tillë, domethënë e  
24 brigadës në batalione, që sapo na përmendët? Kur është bërë  
25 kjo gjë?

1 Pë. Pas zyrtarizimit të brigadës, domethënë, kanë filluar  
2 edhe organizimi i -- edhe emërtimi i batalioneve.

3 Py. Po flasim që nga shkurti i vitit 1999?

4 Pë. Shkurt-mars i vitit 1999, po.

5 Py. Kush i ka emëruar komandantët e batalioneve?

6 Pë. Si komandant të batalioneve janë emëruar zakonisht  
7 njerëzit të cilët edhe e kanë udhëhequr anën organizative të  
8 atyre batalioneve, ose të atyre njësive.

9 Py. Pyetja ime ka të bëjë më tepër me personin ose personat  
10 që kanë emëruar komandantët e batalioneve. Domethënë, kush i  
11 ka emëruar, kush i ka caktuar komandantët e batalioneve?

12 Pë. Ata komandantë i ka caktuar Shtabi i Brigadës 153.

13 Py. Brenda brigadës a keni pasur edhe nën-divizione për  
14 kompanitë ose togat apo thjesht kishte një ndarje prej dy  
15 batalionesh dhe nuk kishte nën-ndarje të tjera brigada?

16 Pë. Brigada ka pasur në përbërje katër batalione dhe një  
17 kompani pranë Shtabit.

18 Py. A kishte një njësi të policisë ushtarake brenda Brigadës  
19 153?

20 Pë. Nuk ishte ndonjë njësi të veçantë, mirëpo në secilën  
21 pjesë, në secilin batalion, kanë ekzistuar nga tre-katër  
22 ushtarë, të cilët e kanë kryer detyrën e policit ushtarak.

23 Py. A kishte ndonjë komandant të përgjithshëm të policisë  
24 ushtarake të Brigadës 153?

25 Pë. Po, ka qenë i emëruar Shukri Kafuna, për komandant të

1 policisë ushtarake.

2 Py. Unë e dëgjova si Shukri Kafuna -- me R.

3 Z. MICHALCZUK: [Përkthim]

4 Py. Zori Shukri Rafuna, a ishte anëtar i komandës së

5 Brigadës?

6 Pë. Sipas pozicionit të tij, po.

7 Py. Çfarë roli ka pasur policia ushtarake brenda Brigadës

8 153?

9 Pë. Roli i policisë ushtarake brenda Brigadës 153 ka pasur --

10 monitorimin e sjelljeve dhe disiplinës brenda njësive të

11 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

12 Py. A ishte pjesë e detyrave të tyre edhe siguria e godinave,

13 e ndërtesave të Brigadës?

14 Pë. Jo e veçantë. Sigurinë e ndërtesave të Brigadës e kanë

15 bërë ushtarët të cilët kanë qenë aty. Jo specifikisht -- dhe

16 jo specifikisht policia ushtarake. Por me ndërrime, janë

17 ndërru ushtarët e njësisë, në përgjithësi.

18 Py. Kujt i raportonte Shukri Rafuni, kush ishte shefi i

19 Shukri Rafunës?

20 Pë. Komandanti i Brigadës.

21 Py. A e kuptoj saktë që Brigada 153 ishte pjesë e zonës

22 operative të Llapit të UÇK-së?

23 Pë. Po e saktë.

24 Py. Si zhvillohej komunikimi ndërmjet komandës së zonës

25 operative të Llapit dhe Brigadës 153?

1 Pë. Kemi pasur tre lloj komunikimesh ose më tepër. Kemi pasur  
2 komunikimin me telefon satelitor. Kemi pasur mundësinë e  
3 komunikimit fizik, duke udhëtuar në drejtim të Shtabit të  
4 zonës operative të Llapit dhe kemi pasur mundësinë e  
5 komunikimit me radiolidhje.

6 Py. Kush nga Brigada 153 komunikonte me komandën e zonës  
7 operative të Llapit?

8 Pë. Zakonisht komandanti i Brigadës.

9 Py. Kush komunikonte me Brigadën 153 nga ana e zonës  
10 operative të Llapit?

11 Pë. Zakonisht ka komunikuar komandanti i zonës.

12 Py. Po flisni për zotin Rustem Mustafa këtu apo jo?

13 Pë. Po.

14 Py. A jeni në dijeni të ndonjë personi tjetër nga komanda e  
15 zonës operative të Llapit që komunikonte me Brigadën 153  
16 përveç Rustem Mustafës?

17 Pë. Po mund të komunikojë edhe zëvendëskomandanti, Kadri  
18 Ksatri.

19 Py. Ndonjë person tjetër përveç Kadri Kastratit dhe Rustem  
20 Mustafës?

21 Pë. Nuk kam njohuri.

22 Py. Në momentin kur Brigada 153 merrte një urdhër nga komanda  
23 e zonës operative të Llapit, si u komunikojë njësive të  
24 Brigadës ky urdhër për ekzekutim, për zbatim?

25 Pë. E thashë edhe -- edhe ajo ka -- është shpërndarë në

1 mënyra të ndryshme. Qoftë përmes radiolidhjeve, qoftë në  
2 mënyrë fizike duke dërguar një person ose dy tre persona,  
3 qoftë edhe nëpërmjet -- me makinë, domethënë, duke shkuar për  
4 të komunikuar me ta. Ka pas raste edhe me shkrim, ndonjë rast  
5 kështu i rrallë.

6 Py. Pra në mënyrë që ta kuptojmë pak më mirë ne, në momentin  
7 kur jepej një urdhër, një urdhër që merrej nga zona operative  
8 e Llapit dhe i jepej komandës së Brigadës, ky urdhër i  
9 dërgohej njësiteve të varësisë së Brigadës 153, që ishin të  
10 stacionuara në Gollak, në fshatrat që ju përmendët në fillim  
11 të dëshmisë tuaj. A është e saktë kjo përmbledhje që bëra unë?

12 Pë. Po.

13 Py. Faleminderit. Tani, po të flasim për juve. Ju keni pasur  
14 pozita të ndryshme brenda komandës së Brigadës 153. Pyetja ime  
15 është kjo: ju vetë personalisht a keni qenë në kontakt me  
16 komandën e zonës operative të Llapit?

17 Pë. Kohë pas kohe.

18 Py. A po flasim për ty që i je përgjigjur komandës së zonës  
19 operative të Llapit apo po flasim që ata të kanë dërguar ty  
20 urdhra, ja u kanë komunikuar këto urdhra juve, apo po flasim  
21 për një komunikim që ka ndodhur në të dyja anët?

22 Pë. Ka pasur komunikime të dyanshme, normal.

23 Py. Pra, kur keni qenë në kontakt me zonën operative të  
24 Llapit, kush është personi ose cilët janë personat, me të  
25 cilët ju keni komunikuar kryesisht?



1 Pë. Unë kam komunikuar kryesisht me komandantin e zonës  
2 operative të Llapit, zotin Rustem Mustafa.

3 Py. A ka ndodhur që ju të keni komunikuar edhe me Kadri  
4 Kastratin?

5 Pë. [E padëgjueshme].

6 Py. Ne dimë nga prova të tjera në këtë lëndë, që një prej  
7 anëtarëve të komandës të zonës operative të Llapit është  
8 Fatmir Humolli. Pyetja ime për ju është kjo: a është Fatmir  
9 Humolli një prej personave me të cilët ju keni komunikuar,  
10 gjithashtu?

11 Pë. Po, Fatmir Humolli është personi i cili më shpesh e ka  
12 vizituar regjionin tonë dhe ka qenë më shumë i lidhur me zonën  
13 operative të Llapit dhe me ne dhe ka qenë person që në të  
14 shumtën e rasteve -- për shembull edhe ka komunikuar mes nesh  
15 edhe zonës operative të Llapit. Varësisht prej lëvizjeve të  
16 tija.

17 Py. Të ndryshojmë paksa temën. Përpara pushimit ju na thatë  
18 që komandanti i njësisë që quhej BIA ose Skifteri, ishte Sali  
19 Mustafa, siç na the. Pyetja ime është kjo: a e dini ju se kush  
20 ishte zëvendësi i Sali Mustafës brenda njësitit BIA?

21 Pë. Jo, nuk e kam ditur.

22 Py. A njihni ndonjë anëtar tjetër të njësitit BIA përveç Sali  
23 Mustafës?

24 Pë. Pak edhe ashtu nga natyra kam probleme me -- me emra, por  
25 nuk kisha -- nuk më kujtohet ndonjë emër specifik, për

1 shembull, i -- nuk më kujtohet për momentin.

2 Py. Zoti Sopi, a e njihni personin me emrin Nazif Metolli, me  
3 nofkën Tabuti?

4 Pë. Personin me emrin Nazif Metolli unë nuk e njoh fare,  
5 ndërsa si pseudonim ose si -- këtë Tabuti e kam dëgjuar -- e  
6 kam dëgjuar dhe më ka bërë përshtypje si -- pseudonim, sepse  
7 për ndryshe nuk kishim ku lidhna ne memorien time.

8 Py. Ky personi, Tabuti, a ishte anëtar i Brigadës 153?

9 Pë. Jo.

10 Py. A e dini nëse ky person, Tabuti pra, ishte anëtar i  
11 njësisë BIA?

12 Pë. Po, kam dëgjuar që ka qenë anëtar i njësitit BIA, po.

13 Py. Zoti Sopi, A pati ndonjë ofensivë serbe në prill të vitit  
14 1999 në Zllash?

15 Pë. Po.

16 Py. Ju vetë morët pjesë në luftimet gjatë kësaj ofensive?

17 Pë. Po.

18 Py. Mund të na thoni ca fjalë për këtë ofensivë, lidhur me  
19 rolin që kishit ju gjatë këtyre luftimeve?

20 Pë. Në prill të vitit 1999 kemi pasur dy ofensiva serbe.

21 Njëra ka qenë më 7 prill të vitit 1999, nga drejtimi i kufirit  
22 me Serbinë, në fshatin e quajtur Prapashticë. Forcat serbe  
23 kanë depërtuar në drejtim të pozicioneve ku gjendej batalioni  
24 i Prapashticës, i Brigadës 153 dhe më 7 prill nga mesdita ka  
25 filluar konfrontimi me forcat serbe, ku kam qenë pjesë edhe

1 vetë unë dhe komandanti i Brigadës, Adem Shehu -- [e  
2 pakuptueshme] deri në 18 prill të vitit 1999.

3 Në ato luftime unë nga Shtabi i Brigadës 153, kam kërkuar  
4 që të caktohem komandanti i operacioneve të luftës në  
5 Prapashticë, detyrë të cilën e kam kërkuar vullnetarisht dhe  
6 m'u ka lejuar nga Shtabi i Brigadës 153. Ato pozicione dhe ato  
7 luftime i kam mbajtur deri më 18 prill të vitit 1999, kur në  
8 drejtim të Brigadës 153 dhe të pozicioneve të saj ka filluar  
9 një ofensivë prej të gjitha drejtimeve, në drejtim të  
10 fshatrave të Gollakut.

11 Në atë kohë, në fshatrat e Gollakut ndodheshin me mijëra  
12 e mijëra njerëz të shpërngulur apo të zhvendosur me dhunë nga  
13 Prishtina, Podujeva dhe nga rajonet e tjera të Kosovës, të  
14 cilët nga lufta ishin tërhequr dhe ishin vendosur në  
15 Prishtinë. Edhe ata persona i depërtoi në drejtim të Gollakut  
16 ushtria dhe policia serbe, dhe për të cilët ne jemi kujdesur  
17 gjatë gjithë kohës.

18 Ndërsa me 18 prill, kur ka filluar ofensiva e  
19 përgjithshme, prapë në atë beteja, në ato luftime, kemi qenë  
20 aktivë të gjithë, pothuajse të gjithë, ushtarët e Brigadës  
21 153. Kjo ofensivë ka zgjatur katër ditë, ku në mesin e  
22 ushtarëve tonë dhe në mesin e civilëve ka pasur shumë humbje.  
23 Forcat serbe kanë granatuar me mjetet dhe teknologjinë që kanë  
24 poseduar nga të gjitha drejtimet, duke mos kursyer as civilët,  
25 as fëmijët, gratë dhe pleqtë. Gjatë kësaj ofensive kanë

1 ndodhur ngjarje të tmerrshme, ku familje të tëra apo njerëz që  
2 kanë ndodhur në shtëpitë e tyre, janë granatuar dhe janë  
3 djegur për së gjalli.

4 Në ditën e katërt, kur e kemi parë se ka humbje të mëdha  
5 si nga civilët po ashtu edhe nga ushtarët tanë, kanë filluar  
6 tërheqja e popullatës në drejtim të Prishtinës, sepse duhej të  
7 evitohesh humbja më e madhe e popullatës, sepse nuk kursente as  
8 gra, fëmijë dhe pleq, domethënë granatim nga distanca.

9 Dhe forcat serbe, në momentin që kanë pësuar ndonjë  
10 humbje nga forcat tona, ata menjëherë janë hakmarrë me  
11 popullatën civile, duke masakruar, duke vrarë fëmijë. Pleq dhe  
12 njerëz që ishin të strehuar në regjionin tonë.

13 Prandaj të gjithë ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare i kanë  
14 formuar një vijë mbrojtëse që t'a ngadalësojë depërtimin dhe  
15 shpëtimin nga masakrat e sigurta të forcave serbe.

16 Kemi bërë përpjekje maksimale. Në anën tonë ka qenë  
17 morali i lartë luftarak, ndërsa në anën e serbëve ka qenë  
18 makineria e tërë dhe zbrazja e çdo arsenali ushtarak në  
19 drejtim të forcave tona por edhe të popullatës civile. E në  
20 qoftë se një ushtar serb ka pasur ndonjë arsye që të vdesë në  
21 Kosovë, ne ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës i kemi  
22 pasur 100 arsye. Sepse ata kanë udhëhequr një luftë për të  
23 mbajtur Kosovën nën pushtim, ndërsa forcat tona kanë punuar  
24 dhe kanë luftuar për çlirimin e vendit të vet.

25 Py. Ju ishit aktiv gjatë luftimeve në të dyja ofensivat apo

1 jo? Ju vetë?

2 Pë. Po.

3 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, më duhet  
4 të konsultohem me kolegen time për një minutë, nëse kemi  
5 pyetje të tjera apo jo.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
7 Patjetër.

8 [Prokurorët e Specializuar këshillohen midis  
9 tyre]

10 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, Prokuroria  
11 nuk ka më pyetje të tjera për sa i përket pyetjeve kryesore.

12 Zoti Sopi, faleminderit. Kaq kemi ne si Prokurori.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
14 Faleminderit, zoti Prokuror.

15 Të shohim, do bëjmë planifikimin tani për pjesën tjetër  
16 të ditës.

17 Zonja Mbrojtëse e Viktimave, jeni gati? A keni pyetje,  
18 një herë dhe a jeni gati t'i bëni këto pyetje tani?

19 ZNJ. PUES: [Përkthim] Po, unë kam nja dy pyetje shumë të  
20 shkurtra dhe do të isha gati që t'i bëja tani.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
22 Atëherë keni fjalën.

23 ZNJ. PUES: [Përkthim] Faleminderit.

24 Pyetje nga Mbrojtësja e Viktimave:

25 Py. Zoti Sopi, përshëndetje. Jam Mbrojtësja e Viktimave,

1 përfaqësoj viktimat pjesëmarrëse në këtë çështje gjyqësore.  
2 Kam vetëm pak pyetje, por përpara se të bëj këto pyetje,  
3 dëshiroj t'ju falënderoj për deklaratën që e keni dhënë sot  
4 paradite, e cila besoj se do jetë shumë e dobishme dhe në  
5 veçanti na ka ndihmuar që të kuptojmë mirë se çfarë ka ndodhur  
6 gjatë marsit dhe prillit të vitit 1999, që sigurisht ka qenë  
7 një periudhë e vështirë për shumë arsye.

8 Shkurtimisht, dëshiroj që të kthehemi tani bashkë te  
9 stërvitja e rekrutëve, pra përgatitja, që ju e përmendët sot,  
10 e përshkruat. Dëgjuam që ju përmendët me emër disa prej tyre  
11 që e kanë zhvilluar stërvitjen me rekrutët, por për sqarim,  
12 njëri prej emrave që ju cekët ishte Ilmi Berovci. Është në  
13 transkriptimin në faqen 48, rreshtat 2 deri në 3.

14 Do t'ju pyesja dhe ju kërkoj ndjesë paraprakisht për  
15 ndonjë keq-shqiptim nga ana ime: është Ilmi Berovski apo mund  
16 të jetë edhe Emin?

17 Pë. Emin.

18 Py. Emin. Ah, në rregull, faleminderit.

19 Faleminderit. Po vrisja nëse ishin -- mbase kishte ndonjë  
20 gabim të vogël në transkriptim. A ndodh t'ja dini nofkën Emin  
21 Borovcit?

22 Pë. Nofkën -- për momentin nuk më kujtohet. Emin Borovci --

23 Më duhet të kujtoj -- nuk më -- nuk kam -- nuk më kujtohet.

24 Triumfi, Triumph. Tash mu kujtu. Ka pasur një nofkë - Triumfi.

25 Triumfi.

1 Py. Shkëlqyeshëm. Faleminderit shumë. Unë kaq kisha nga ana  
2 ime, faleminderit.

3 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

4 Faleminderit, Mbrojtëse e Viktimave.

5 Atëherë i kthehem Avokatit të Mbrojtjes. Keni pyetje. Jam  
6 e sigurt që duhet të keni, po a jeni gati që t'i bëni tani  
7 këto pyetje?

8 Z. VON BONE: [Përkthim] Patjetër që kemi pyetje, e  
9 nderuar Gjykatëse, por preferojmë që t'i bëjmë nesër, nëse  
10 është e mundshme. Thjesht sepse duam që të konsultohemi edhe  
11 me klientin tonë sa i takon dëshmisë së zotit Sopi dhe disa  
12 tema të tjera. Patjetër që kemi shumë pyetje, por duam  
13 patjetër të vlerësojmë një sërë gjërash me klientin.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po a  
15 nuk është e mundshme që ta bëni këtë gjatë një orë e gjysmë në  
16 vijim? Sepse e kemi kohën në sallë që na është caktuar, që  
17 është shumë e çmuar. Unë kohën për t'u përgatitur dua që t'ju  
18 jap edhe të nesërmen e keni në dispozicion, sigurisht, por ora  
19 është vetëm 12.15. Mund t'ju jap dy orë që të bëni një pjesë  
20 të përgatitjes dhe pastaj të bëjmë sesionin normal, siç e  
21 kishim ndërmend?

22 Z. VON BONE: [Përkthim] Pra deri në orën 14.15.

23 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

24 Normalisht e kemi deri në orën 14.00. Pra në orën 14.15 bëjmë  
25 edhe një orë e gjysmë por pastaj vazhdojmë nesër, por t'a

1 përdorim sa më shumë kohën që na mundësohet në sallë. Jemi të  
2 gjithë këtu, nuk kemi ndërprerje nga COVID-i dhe nuk dihet se  
3 ç'na sjell dita e re.

4 Z. VON BONE: [Përkthim] Mendoj s'ka problem, se edhe ne  
5 duam të hamë drekë, sigurisht.

6 K RYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Por u  
7 përpoqa ta mendoja edhe këtë, por kemi bërë edhe një farë  
8 pushimi.

9 Zoti Sopi, atëherë. Do të bëjmë tani një pushim prej dy  
10 orësh, deri në orën 14.15, të hani drekë. Shpresoj do të keni  
11 mundësi edhe të pushoni dhe pastaj do të vazhdojmë me pyetjet  
12 që do t'i bëjë Avokati i Mbrojtjes. E qartë është zoti Sopi?

13 DËSHMITARI: {përkthim} Po, e qartë.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

15 Zonja asistente e sallës, ju jeni ngritur në këmbë  
16 tashmë. Faleminderit që po e shoqëroni dëshmitarin të dali nga  
17 salla. Faleminderit.

18 [Dëshmitari largohet nga salla e gjyqit]

19 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

20 Faleminderit zonja asistente.

21 Bëjmë ndërprerjen e seancës këtu, deri në orën 14.15.

22 --- Pushimi i drekës fillon në orën 12.16

23 --- Seanca rifillon në orën 14.15

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Së

25 pari shikojmë të pranishmit.



1 Për Zyrën e Prokurorit të Specializuar, ka ndryshime?

2 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Ashtu është, nuk ka asnjë

3 ndryshim.

4 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

5 Mbrojtësja e Viktimave?

6 ZNJ. PUES: [Përkthim] Asnjë ndryshim nga ana jonë.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

8 Avokati i Mbrojtjes?

9 Z. VON BONE: [Përkthim] Asnjë ndryshim.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shoh

11 dhe zoti Mustafa që është i lidhur përmes video lidhjes.

12 Shpresoj që sot pas dreke të vijojë të funksionojë lidhja.

13 Atëherë do të vazhdojmë me pyetjet që do t'ia bëjnë

14 dëshmitarit.

15 Znj. Asistente ju lutem shoqërojeni dëshmitarin të hyjë

16 në sallë.

17 [Dëshmitari vijon dëshminë]

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë

19 se u rikthyet. Ju lutem. Mirë se u kthyet zoti Sopi. Do të

20 vazhdojmë tani me dëshminë tuaj, pyetjet që do t'ua bëj

21 Avokati i Mbrojtjes, i cili ka rendin tani me kundra pyetjet.

22 Zoti Avokat i Mbrojtjes, keni fjalën.

23 Z. VON BONE: [Përkthim] Faleminderit shumë, e nderuar

24 Gjykatëse.

25 Të nderuar Gjykatës, dua ta filloj me një referencë që

1 është numër ERN069474-TR-ET, pjesa 1, rreshtat nga 1 deri në  
2 3.

3 Pyetje të palës tjetër z. von Bone:

4 Z. VON BONE: [Përkthim]

5 Py. Zoti Sopi mirëdita.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Numri  
7 i faqes?

8 Z. VON BONE: [Përkthim] Faqja 10.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
10 Faleminderit.

11 Z. VON BONE: [Përkthim]

12 Py. Zoti Sopi, a ju kujtohet intervista që keni bërë me Zyrën  
13 e Prokurorit të Specializuar?

14 Pë. Po.

15 Py. A ju kujtohet nëse keni dashur t'u përgjigjeni apo mos  
16 t'u përgjigjeni pyetjeve në atë intervistë?

17 Pë. Ju kam përgjigjur pyetjeve që i kam dit.

18 Py. Kam një pyetje lidhur me këtë zoti Sopi. Dua që t'ua  
19 rikujtoj një fjali të cilën deshëm ta sqaronim. Në intervistën  
20 që i keni dhënë ZPS-së, ju bëtë pyetjen:

21 "A mund ta ushtroj të drejtën time e të mos përgjigjem"?

22 Në anglisht nuk thuhet gjë, por në shqip është "për të gjitha  
23 pyetjet".

24 A ju kujtohet që ta keni bërë këtë pyetje?

25 Pë. Po.

1 Py. Cila ka qenë arsyeja pse ju e bëtë këtë pyetje?

2 Pë. Arsyeja ka qenë se, ajo periudhe tek ne ngjall ndjenja të  
3 jashtëzakonshme emocionale kur na kujtohen vuajtjet e popullit  
4 tonë në shekuj, kur na kujtohen vuajtjet e popullit tonë gjatë  
5 luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, kur kemi pa masakra  
6 dhe askush nuk është marrë me --. Mendojmë se nuk u çua deri  
7 në fund zbardhja e krimeve të luftës dhe përgjegjësit kryesor  
8 të cilët kanë ba krime në Kosovë, nuk kanë dalë përpara  
9 drejtësisë.

10 Prandaj, si gjendje emocionale dhe që ajo revoltë, e kam  
11 dash që të mos iu përgjigjem fare pyetjeve dhe vetëm kjo ka  
12 qenë arsyeja.

13 Py. Por, përveç kësaj, keni ardhur me vullnetin tuaj të lirë  
14 që të intervistoheni nga ZPS-ja?

15 Pë. Jo, nuk kam ardhur me vullnetin tim të lirë. Jam ftuar  
16 nga ZPS-ja.

17 Py. Në ndonjë mënyrë a tjetër, a keni bërë ndonjë marrëveshje  
18 me Zyrën e Prokurorit të Specializuar përpara se ta jepnit  
19 deklaratën?

20 Pë. Jo, nuk kemi bërë.

21 Py. Përpara se të dëshmonit në Zyrën e Prokurorit të  
22 Specializuar, a keni marrë ndonjë kërcënim për të bërë këtë?

23 Pë. Jo, kërcënim nuk kam marrë.

24 Py. As më përpara, as më mbrapa?

25 Pë. Kurrfarë kërcënime nuk kam pas. Vetëm kam pas një ftesë

1 që të paraqitem pranë Zyrës së Prokurorit të Specializuar.

2 Py. Në rregull. Me aq sa dini, anëtarët e familjes suaj, janë  
3 kërcënuar ndonjëherë, lidhur me faktin që ju do të dëshmoni në  
4 Gjykatë, në këtë çështje gjyqësore?

5 Pë. Jo, asnjëherë.

6 Py. Faleminderit shumë për sqarimin. Dëshiroj që fillimisht  
7 t'i kthehemi periudhës kur jetonit në Zllash. Pyetja e parë, a  
8 banoni ende në Zllash?

9 Pë. Jo, në Prishtinë.

10 Py. Në rregull. T'i kthehemi tani periudhës kur ju banonit në  
11 Zllash dhe sigurisht dua që të bisedoj me ju për periudhën  
12 1998 dhe 1999. E them të qartë këtë edhe për pjesëmarrësit që  
13 janë në sallë, lidhur me pyetjet që do t'i bëj.

14 Sa kohë kishit që banonit në Zllash në atë kohë deri në  
15 vitin 1998-1999. Sa kohë kishit, pra jeni lindur, jeni rritur  
16 aty?

17 Pë. Në Zllash jetojmë prej, familja ime jeton në Zllash prej  
18 vitit 1878, kur barbaria serbe na përzuri nga trojet tona  
19 shekullore, të cilat ndodheshin në regjionin e Nishit dhe na  
20 deportoi për në Turqi apo Shqipëri apo sa ma larg trojeve  
21 tona. Në atë kohë familja ime, të parët e mi, janë vendosur në  
22 Zllash dhe që prej atëherë ne jetojmë në Zllash.

23 Unë kam lindur në Zllash dhe kam jetuar gjithë kohën në  
24 Zllash, me përjashtim të 4 viteve që kam munguar në Zllash,  
25 kam qenë në burgjet e Serbisë.

1 Py. E kuptoj, faleminderit shumë. Pra e njihni atë zonë shumë  
2 mirë, besoj?

3 Pë. Po, e njoh.

4 Py. Sa kohë kishit që e njihnit zotin Rrahman Dini?

5 Pë. Zotin Rrahman Dini e njoh prej vitit 1983.

6 Py. Prej sa kohe e njihnit familjen Krasniqi?

7 Pë. Cila fam--. A, familja Krasniqit--. Cila familja  
8 Krasniqi?

9 Py. Familja Krasniqi e cila ka si shtëpi kompleksin, e ka  
10 shtëpinë tek kompleksi për të cilën folëm sot, pra në  
11 kompleksin e Zllashit.

12 Pë. Ne jemi bashkëfshatarë aty dhe ne jemi njohur prej  
13 kohësh.

14 Py. Ata ishin pronarë të vetëm të asaj shtëpisë, apo kishte  
15 edhe të tjerë të cilët banonin aty?

16 Pë. Jo, pronarë të vetëm kanë qenë ata. Por nuk kanë qenë  
17 duke banuar aty.

18 Py. Thoni që pronarë ishin vetëm ata, kush, për kë po flasim  
19 me saktësi tani?

20 Pë. Adem Krasniqi ka qenë kryefamiljar i asaj shtëpie.

21 Py. Po vëllezër, motra që kishin shtëpi aty në kompleks, a  
22 kishte?

23 Pë. Ai ka qenë kryefamiljari. Për anëtarë të tjerë të  
24 familjes ka pas ai vëllezër, më duket se ata kanë vdekur më  
25 herët. Ndërsa pronari ka qenë ai.

1 Py. Prej sa kohe, prej kur. Jo, do ta them ndryshe. A është e  
2 vërtetë që në një moment ndodhi që UÇK-ja mund t'i përdorte  
3 familjet e anëtarëve të familjes kur ata nuk ndodheshin aty?

4 Pë. Nuk e kuptova mirë pyetjen.

5 Py. Kur flasim për shtëpitë dhe kur familja Krasniqi nuk  
6 jetonte aty, a mund të na thoni si ndodhi që njerëzit e UÇK  
7 munden që t'i shfrytëzonin, t'i përdornin këto shtëpi? Si  
8 ndodhi kjo? Si ndodhte kjo, mund të na shpjegoni?

9 Pë. Të gjitha shtëpitë në regjionin e Gollakut gjatë  
10 periudhës së luftës, kanë qenë shtëpi të Ushtrisë Çlirimtare  
11 të Kosovës. Në të gjitha shtëpitë ne kemi has në mirëkuptim  
12 dhe pa asnjë rezervë na janë dhanë në shfrytëzim. Duke filluar  
13 nga shtëpia ime e cila ka qenë me plot anëtarë të familjes, ka  
14 qenë në shërbim të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Dhe shtëpi  
15 të tjera të cilat të gjitha kanë mund që Ushtria Çlirimtare e  
16 Kosovës t'i shfrytëzoi. Ne nuk kemi pas kazerma dhe nuk kemi  
17 pas vend përqendrimi të përhershme, por i kemi shfrytëzuar  
18 shtëpitë e fshatarëve për strehimin tonë gjatë periudhës së  
19 luftës së Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës.

20 Py. E kuptoj. Kur thoni fshatarët, përfshini edhe familjen  
21 Krasniqi e cila ra dakord, u pajtua që UÇK mund t'i përdorte  
22 shtëpitë e tyre për strehim?

23 Pë. Po.

24 Py. Prej kur ose kur filloi kjo?

25 Pë. Nuk jam i sigurt.

1 Py. Ky përdorim, ky shfrytëzim?

2 Pë. Nuk më kujtohet saktë koha, por mund të jetë fillimi i

3 vitit 1999, dikur aty. Ose ndoshta edhe pak ma herët.

4 Py. Kush bëri marrëveshje me familjen Krasniqi që UÇK-ja mund

5 ta përdorte, pra nga ana e UÇK-së kush ishte ai që ia kërkoi,

6 ia bëri këtë kërkesë, si ndodhi?

7 Pë. Nuk ka pas ndonjë kërkesë specifike, por pronari ose i

8 zoti i shtëpisë, Krasniqi, ka shprehur dëshirën vullnetarisht

9 që, shtëpitë të cilat e ka posedu ai të jenë në shërbim të

10 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, kurdo që të kenë nevojë.

11 Py. Po kujt ia bëri këtë, kujt ia ofroi nga UÇK-ja ai?

12 Pë. Neve, të gjithëve. Kur ka pas nevojë kemi qenë të mirë se

13 ardhur në secilën familje, në secilën shtëpi.

14 Py. A keni folur ju vetë personalisht me zotin Krasniqi sa i

15 takon përdorimit të shtëpive të tij?

16 Pë. Edhe vetë kam folur.

17 Py. Në rregull. A e mbani mend kur ka ndodhur kjo?

18 Pë. Jo, as jam i sigurt, por e di se na ka thonë se, kurdo që

19 t'ju nevojitet, kjo është në dispozicionin tuaj dhe s'ka

20 problem.

21 Py. Kush nga UÇK-ja e ka përdorur realisht atë vend, atë

22 kompleks aty?

23 Pë. Ai kompleks për shembull, është quajtur baza e Skifterëve

24 ose baza e gueriljes, BIA. Mirëpo aty kanë qëndru edhe ushtarë

25 të zonës operative të Karadakut një kohë, një pjesë. Sa? Nuk e

1 di. Me sa di unë.

2 Py. A e dini ju se kush nga njësitë BIA qëndronte në atë  
3 kompleks?

4 Pë. Si persona, jo. Veç e di që ushtarët e Ushtrisë  
5 Çlirimtare të Kosovës. Nuk kam njohuri për individë apo  
6 persona. Nuk kam.

7 Py. Pse guerilja BIA ose ushtarë të UÇK mund ta përdornin atë  
8 vendndodhje specifike konkrete? Pra çfarë kishte të veçantë ky  
9 vend?

10 Pë. Asgjë të veçantë. Vetëm se vend ku mund të rrinin dhe të  
11 qëndronin ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Asnjë gjë  
12 të veçantë nuk ka pas. Shtëpi e zakonshme.

13 Py. Në rregull. Ju thatë se shumë fshatra kishin njësitë e  
14 veta të UÇK, në qoftë se mund të shprehemi kështu. Pra, të  
15 shpërndara gjithandej në zonën e Gollakut. A ishte kështu  
16 rasti edhe me kompleksin e Zllashit ku gjendeshin shtëpitë e  
17 familjes Krasniqi?

18 Pë. Po.

19 Py. Që prej sa kohe kanë qëndruar, kur kanë filluar të  
20 qëndrojnë aty ata?

21 Pë. Të thashë, në fund te vitit 1998, fillimi i vitit 1999.  
22 Aty dikur.

23 Py. Në rregull. A ka pasur njerëz të tjerë kur Brigada 153  
24 është krijuar, pra a ka pasur anëtarë të brigadës të cilët  
25 kanë qëndruar atje? Ose kanë fjetur atje?



1 Pë. Ku mendoni?

2 Py. Pyetja ime është, a ka pasur anëtarë, ushtarë të Brigadës

3 153 që qëndronin në kompleksin e familjes Krasniqi?

4 Pë. Nuk kam njohuri. Nuk e di. Nuk e di.

5 Py. Në rregull. Kur flasim për atë kompleksin dhe folëm edhe

6 më herët gjatë ditës së sotme rreth kompleksit, a ju kujtohet

7 se sa ndërtesa, sa godina kishte mesatarisht brenda atij

8 kompleksi?

9 Pë. Saktë nuk më kujtohet, sa godina. Por, shtëpi ka pasur

10 një farë rangu shtëpive, ku ka jetu familja.

11 Py. Atje qëndronin ushtarët e UÇK, në atë shtëpi qëndronin

12 ushtarët e UÇK?

13 Pë. Po, po.

14 Py. A e dini ju se sa i madh ishte grupi i BIA-s, a ke

15 njohuri për këtë?

16 Pë. Jo, nuk pas njohuri. Nuk kam njohuri sa anëtarë ka

17 numëruar. Nuk kam njohuri.

18 Py. Përpara se sa të krijohej Brigada 153, mesatarisht, sa

19 anëtarë ishin ushtarë të UÇK që ose jetonin aty, ose qëndronin

20 aty?

21 Pë. Nuk e di për numrin, nuk e di për numrin e anëtarëve. Se

22 aty kanë qarkulluar, kanë ndenjor një kohë disa, një kohë disa

23 dhe nuk ka qenë numri standard i anëtarëve. Ka ndryshuar

24 numri, për shembull. Me sa di unë, nuk është që ka qenë

25 standard, kaq është numri. Nuk kam njohuri.

1 Py. A është e saktë të thuhet që persona edhe nga zona të  
2 tjera mund të qëndronin aty, në qoftë se kishin nevojë të  
3 qëndronin diku?

4 Pë. Kanë qëndruar.

5 Py. A jeni ju në dijeni se, çfarë qëllimi kishte secila prej  
6 ndërtesave në atë kompleks specifik, d.m.th., për çfarë  
7 qëllimi konkret janë përdorur ndërtesat aty?

8 Pë. Të gjitha ndërtesat, sipas dijenisë sime, janë përdorur  
9 që të flenë ushtarët, të qëndrojnë ushtarët. Kurrfarë  
10 destinacioni tjetër unë nuk di.

11 Py. Unë dua të flas pak për brigadën, në brigadën ku  
12 eventualisht ju ishit pjesë e komandës. Pyetja ime është: kur  
13 Brigada 153 u themelua, sa vetë kishte mesatarisht kjo  
14 brigadë, sa pjesëmarrës kishte mesatarisht?

15 Pë. Nuk e kam dit numrin dhe nuk mund ta di as sot. Sepse  
16 numri i anëtarëve të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës nga dita  
17 në ditë ka ndryshuar. Sepse jemi pajisur me njerëz që kanë  
18 ardh të rinj dhe kërkesa dhe interesimi i njerëzve për t'u  
19 rreshtuar në radhët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, ka qenë  
20 jashtëzakonisht i madh. Dhe jam i bindur se ne as 20-30 për  
21 qind të njerëzve që kanë qenë të interesuar, nuk kemi mund t'i  
22 përfshijmë në radhët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Edhe  
23 pse kanë shpreh dëshirë të madhe. Arsyeja ka qenë se nuk kemi  
24 pas vend ku t'i strehojmë, nuk kemi pas armatim të mjaftueshëm  
25 që t'i furnizojmë me armatim dhe municion. Kështu, qe pa të

1 drejtë iu kemi cenuar një kërkesë, një të drejtë dhe një  
2 vullnet që të luftojnë për vendin e vet.

3 Ndërsa numri ka ndryshuar nga dita në ditë. Kanë ardh  
4 nëpër njësitet ku i kemi pas, janë regjistruar ushtarë të  
5 rinj. Prandaj numri nuk është kurrë i saktë. Në secilën  
6 periudhe ka pas ndryshime.

7 Py. A mund të kenë qenë më shumë se 100 vetë?

8 Pë. Po, po. Ma shumë, sigurisht.

9 Py. Në rregull. A ju kujtohet kur NATO-ja bombardoi  
10 Prishtinën? A ju kujtohet se kur ka ndodhur kjo, kur kanë  
11 ndodhur bombardimet e NATO-s në Prishtinë?

12 Pë. Më 24 mars 1999 kanë filluar bombardimet e NATO-s.

13 Py. Në atë kohë ose rreth asaj kohe, pra pas bombardimeve të  
14 NATO-s, a vinin refugjatë në zonën e Zllashit?

15 Pë. Pas fillimit të bombardimeve në Kosovë nga forcat e NATO-  
16 s, Serbia ka marrë një spastrim të përgjithshëm etnik dhe të  
17 krejt popullatës shqiptare nga Prishtina dhe rrethinat e saj,  
18 po ashtu nga Podujeva dhe i ka ndjek, i ka drejtu në drejtim  
19 të regjioneve të Gollakut.

20 Py. Ju vetë, a keni parë, a keni përjetuar ndonjë fluks  
21 njerëzish që janë larguar nga Prishtina dhe kanë shkuar në  
22 drejtim të regjioneve të Zllashit?

23 Pë. Po, shumë. Kemi parë me sytë tonë, po. Dhe të gjitha  
24 familjet që kanë qenë duke jetuar në ato fshatra, i kanë prit  
25 në shtëpitë e tyre dhe i kanë furnizuar me ushqime të nevojshme,

1 sepse ata kanë ik pa kurrgjë. Duarthatë, me fëmijë të vegjël,  
2 me njerëz të sëmurë, me traktorë, në këmbë, qysh kanë mund me  
3 u tërheq, nën kërcënimin e armëve serbe.

4 Py. Këta refugjatë që po vinin në Zllash, kanë qëndruar dhe  
5 brenda apo përreth kompleksit të familjes Krasniqi?

6 Pë. Jo. Me sa di unë, jo. Nuk kam njohuri. Njerëzit që kanë  
7 ardh nga Prishtina dhe nga Podujeva, janë strehuar ku kanë  
8 mund, gjithandej. Nuk kam njohuri a ka pas refugjatë brenda  
9 kompleksit, apo jo. Nuk kam njohuri.

10 Py. Po ju personalisht, a keni qenë i pranishëm vetë në atë  
11 kompleks gjatë kësaj periudhe kohe? Po dua të them pas  
12 bombardimit të NATO-s, rreth kësaj periudhe për shembull në 2-  
13 3 javët në vijim, a keni qenë vetë ju personalisht në  
14 kompleks?

15 Pë. Nuk jam shumë i sigurt. Unë kohë pas kohe edhe kam qenë e  
16 kam vizituar edhe atë kompleks edhe çdo bazë të Ushtrisë  
17 Çlirimtare të Kosovës. Nuk jam i sigurt a kam qenë pikërisht  
18 në atë kohë, a kam qenë a jo. Edhe nuk jam i sigurt. Sepse unë  
19 kam qenë gjithmonë në lëvizje, gjithmonë kam pas detyra rreth  
20 përballjes me forcat armike. Kam komanduar njësi të ndryshme  
21 të Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në vijën e frontit.

22 Py. Ju thatë që keni shkuar atje rast pas rasti. A ju  
23 kujtohet në fillim të prillit, se sa herë keni qenë atje,  
24 mesatarisht?

25 Pë. Jo, nuk më kujtohet. Tash nuk më kujtohet, nuk di.

1 Py. Më shumë se dy herë, më shumë se pesë herë, më pak se  
2 kaq?

3 Pë. Nuk jam i sigurt. Nuk di. Nuk e di.

4 Py. Në rregull. A kishit ndonjë person konkret me të cilin  
5 kontaktonit kur ishit në kompleks, d.m.th. me njerëzit që  
6 ishin aty që mund të ishin ushtarë të UÇK-së, apo ndonjë  
7 person tjetër, çdo person tjetër?

8 Pë. Nuk më kujtohet që kam pas ndonjë takim specifik. Nuk më  
9 kujtohet, absolut.

10 Py. Zoti Sopi, Brigada 153, a mund të na shpjegoni nëse  
11 kishte ndonjë gjë të organizuar sa i takon disiplinës së  
12 brendshme, në kuadrin e Brigadës 153?

13 Pë. Nuk di në çfarë kuptimi. Vetë disiplinën e kemi pas  
14 vazhdimisht. Gjithmonë ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të  
15 Kosovës kanë qenë tejet të disiplinuar.

16 Py. E kuptoj. E kuptoj, që ushtarët ishin të vetëdisiplinuar.  
17 Po në rastet kur shkelej disiplina, si trajtohej një rast i  
18 tillë?

19 Pë. Nuk ka ndodhë, por ne në atë anën teorike qysh e kemi  
20 menduar, në qoftë se një ushtar i Ushtrisë Çlirimtare të  
21 Kosovës shkel ndonjë rregull të Ushtrisë Çlirimtare të  
22 Kosovës, dënimi mund të jetë, vërejtje ose dënimi ma i madh do  
23 të ishte largimi nga radhët tona apo çarmatosja e tij, sepse  
24 vullneti i çdo ushtari të Ushtrisë Çlirimtare ka qenë që të  
25 jetë pjesë e saj. Dhe dënimi maksimal do të ishte çarmatosja e

1 tij dhe moslejimi i tij që të marrë pjesë në luftën e Ushtrisë  
2 Çlirimtare të Kosovës. Dënim tjetër nuk kemi menduar.

3 Py. Kush kishte kompetencë për t'a bërë këtë gjë?

4 Pë. Kishte komandanti i brigadës në qoftë se një ushtar ose  
5 komandanti i batalionit në qoftë se në një batalion në një  
6 tjetër vend ku kanë vepru, ka pas të drejtë dhe komandanti i  
7 batalionit që të marrë një vendim të tillë. D.m.th.

8 çarmatosjen dhe demobilizimin e një ushtari, i cili rastësisht  
9 ka shkel ndonjëherë prej rregullave disiplinore që kanë qenë.

10 Py. Përpara se të ishte krijuar brigada, a kishte ndonjë lloj  
11 discipline që ekzistonte përpara UÇK-së? E kam fjalën përpara  
12 kohës së krijimit të Brigadës 153.

13 Pë. Kjo disiplinë ka vlejti gjithmonë, prej krijimit të  
14 njësiteve të para, në qoftë se dikush shkel ndonjë rregull ose  
15 ndonjë... Se ma herët ka qenë veç forma organizative, nuk kemi  
16 pas konfrontime ose luftime. Dhe në qoftë se është vërejt  
17 diçka e tillë, nuk ashtë angazhu, nuk ashtë pranë në radhët e  
18 Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës. Kjo ka qenë dënimi.

19 Py. E kuptoj. Sa i takon këtyre masave disiplinore, a kishte  
20 rregulla konkrete? Për shembull, a kishte ndonjë botim apo një  
21 fletore apo ndonjë broshurë që i ishte dhënë ushtarëve, në  
22 version të shkruar ose jo? D.m.th., me fjalë të tjera si u  
23 komunikoheshin këto rregulla ushtarëve?

24 Pë. Nuk kam pa, nuk di. Nuk ma merr mendja që... S'i kam pa  
25 vetë unë, nuk kam pa rregulla të tilla. Por këtu

Dëshmitari: Fatmir Sopi (Seancë e hapur)

Faqe 79

Pyetje të palës tjetër z. von Bone

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 vetëkuptoheste, d.m.th., kanë qenë si rregulla qoftë në njësi  
2 të caktuara, qoftë në nivel të brigadës, këto rregulla kanë  
3 vlejti gjithë.

4 Py. Në rregull. Kur ju pyeta se, kush e kishte kompetencën  
5 për ta bërë këtë gjë, ju thatë që mund të ishte komandanti i  
6 brigadës ose komandanti i batalionit. Kush brenda komandës së  
7 brigadës mund ta ushtronte një kompetencë të tillë?

8 Pë. Mund ta ushtronte komandanti i brigadës, thashë. Meqë unë  
9 nuk kam ndonjë rast, nuk di ndonjë rast që dikush është dënuar  
10 në atë kuptimin e për sa thashë ma parë. Nuk kam njohuri që,  
11 dikush për shembull, është çarmatos ose është demobilizuar nga  
12 Ushtria Çlirimtare. Nuk kam njohuri. Por në shtab të brigadës  
13 i kemi bisedu këto gjëra se, këto janë masat që mund të merren  
14 në qoftë se një ushtar i UÇK-së i shkel rregullat ose  
15 disiplinën ushtarake.

16 Py. Ishte edhe policia ushtarake. Ta formuloj edhe një herë.  
17 Çfarë funksioni apo çfarë detyrash kishte policia ushtarake?  
18 Cilat janë detyrat konkrete për policinë ushtarake, çfarë  
19 bënte ushtria ushtarake?

20 Pë. Pikërisht këtë që thashë përpara. Policia ushtarake ka  
21 qenë e detyruar që brenda njësisë së saj...

22 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zoti  
23 dëshmitar. Shoh që Prokurori është ngritur në këmbë edhe unë  
24 vetë në fakt po pyesja veten.

25 Zoti Prokuror, e keni ju fjalën.

1           Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, këtë  
2   çështje e kemi diskutuar në hollësi përpara pushimit të  
3   drekës. Sepse fillimisht zoti Sopi dha vetë vullnetarisht këtë  
4   informacion dhe unë pastaj bëra disa pyetje pasuese për të  
5   shpjeguar se cilat ishin funksionet kryesore të ushtrisë  
6   [sipas përkthimit] ushtarake. Nuk e di cila është arsyeja që  
7   pse po bëhen të njëjtat pyetje. Ndoshta për t'a ngatërruar  
8   dëshmitarin, por këto janë çështje të cilat u sqaruan përpara  
9   pushimit të drekës.

10           KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
11   Avokat, do t'ju kërkoja që të mos e përsëritni këtë pyetje  
12   sepse i kemi dëgjuar përgjigjet e kësaj pyetje. Por, në qoftë  
13   se ju duhet ta bëni këtë si pyetje të parë për t'u pasuar me  
14   pyetje të tjera, ju lutem na e sqaroni këtë gjë.

15           Z. VON BONE: [Përkthim] Kjo ishte ideja. Doja që të  
16   prezantoja këtë temë dhe pastaj të bej disa pyetje të tjera  
17   shitesë.  
18   Py. A mund të na thoni ju lutem se, çfarë marrëdhënie  
19   përgjegjësie ekzistonte në qoftë se kishte një shkelje  
20   disipline brenda brigadës, në çfarë kohe, në çfarë momenti do  
21   të futej në lojë policia ushtarake? Apo nuk kishte fare rol  
22   policia ushtarake? Pra, çështja e disiplinës së brendshme të  
23   brigadës, ishte çështje tërësisht në kompetencë të brigadës,  
24   apo kishte ndonjë moment të caktuar ku futej në lojë policia  
25   ushtarake?



Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Fatmir Sopi (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493  
Pyetje të palës tjetër nga z. Von Bone Faqe 81  
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 Pë. Jo. Policia ushtarake vetëm i ka monitoruar, i ka  
2 përcjellë sjelljet e ushtarëve të njësisë përkatëse.  
3 Përndryshe nuk ka intervenuar në qoftë se nuk ka ndonjë  
4 shkelje, nuk ka pas të merrej me atë punë. Ndërsa policia  
5 ushtarake në rast konflikti, në rast beteje, në rast lufte,  
6 kanë qenë si të gjithë ushtarët e tjerë të angazhuar në  
7 operacione luftarake.

8 Py. Në qoftë se njerëz të caktuar arrestoheshin nga policia  
9 ushtarake, çfarë bëhej me ta?

10 Pë. Unë nuk kam informacion që policia ushtarake ka arrestuar  
11 dikë.

12 Z. VON BONE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, do të doja  
13 t'ju kërkoja të kalonim në seancë private.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në  
15 seancë private do të na shpjegoni pse e kërkon seancën  
16 private.

17 Z. VON BONE: [Përkthim] Po.

18 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.  
19 Sekretare e seancës, a mund të na kaloni në seancë private, ju  
20 lutem.

21 ~~[Seancë private]~~ [Seancë e hapur]

22 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,  
23 jemi në seancë private.

24 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

25 Faleminderit zonja Sekretare.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Fatmir Sopi (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493  
Pyetje të palës tjetër nga z. Von Bone Faqe 82  
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 Tani e keni fjalën ju zoti Avokat.

2 Z. VON BONE: [Përkthim]

3 Py. Zoti Sopi, ju na folët rreth komandantit të policisë  
4 ushtarake, që ishte zoti Rafuna, është kështu? E saktë është  
5 kjo? Që prej cilës kohë ishte zoti Rafuna komandant i policisë  
6 ushtarake?

7 Pë. Nuk e kam këtë informacion. Nuk e di saktë datën prej kur  
8 është emëruar. Nuk më kujtohet.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

10 Avokat, pyetja ime është që, do të doja që të na shpjegonit  
11 shkurtimisht që pse kemi kaluar në seancë private.

12 Ju lutem zoti dëshmitar, mund t'i hiqni pak dëgjueset?

13 Fjala për juve zoti Avokat.

14 Z. VON BONE: [Përkthim] Unë mund të përdor emra të  
15 përveçëm ose dëshmitari mund të përdori emra të njerëzve që  
16 nuk duam që të nxirren publikisht. Kjo është arsyeja pse  
17 kërkova seancë private.

18 Do ta bëj ndoshta nja 2-3 herë dhe mund të bëj pyetjen e  
19 përgjithshme dhe pastaj për pyetjet e tjera të detajuara, mund  
20 të kërkoj që të kalojmë në seancë private.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në  
22 rregull.

23 Në qoftë se bëhet fjalë për pyetje të tjera shtesë, nuk  
24 është e nevojshme që ta bëni në formë pyetjeje, por mund të  
25 përsërisni atë çfarë ka thënë dëshmitari si përgjigje.

1           Zoti Sopi, mund t'i vendosni dëgjueset.

2           Ju lutem vazhdoni zoti Avokat.

3           Z. VON BONE: [Përkthim]

4   Py.   Zoti Sopi, a keni njohuri në qoftë se zoti Rafuna kishte  
5   zëvendës?

6   Pë.   Jo, nuk kam njohuri. Nuk e di kush është.

7   Py.   A njihni ndonjë person tjetër që ishte në Zllash apo në  
8   afërsi të Zllashit, në detyrën si oficer i policisë ushtarake?

9   Pë.   Nuk kam njohuri. Nuk di.

10   [REDAKTUAR]

11   [REDAKTUAR]

12   Py.   Po. A njihni ndonjë person me këtë emër?

13   Pë.   Me këtë mbiemër ka shumë persona.

14   Py.   Në rregull. A njihni dikë që kishte një pozitë në  
15   policinë ushtarake që kishte këtë mbiemër?

16   Pë.   Për momentin nuk më kujtohet, nuk di. Ama ka shumë  
17   persona me këtë mbiemër.

18   Py.   A e ke dëgjuar ndonjëherë një person me emrin [REDAKTUAR]

19   [REDAKTUAR]

20   Pë.   Po.

21   Py.   Si e njihni këtë person?

22   Pë.   Ka qenë ushtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës edhe ky.

23   Py.   Në cilën zonë ka qenë ushtar?

24   Pë.   [REDAKTUAR] Njësi.

25   [REDAKTUAR]

Dëshmitari: Fatmir Sopi (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493  
Pyetje të palës tjetër nga z. Von Bone Faqe 84  
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 [REDAKTUAR]

2 [REDAKTUAR]

3 [REDAKTUAR]

4 [REDAKTUAR]

5 [REDAKTUAR]

6 [REDAKTUAR]

7 [REDAKTUAR]

8 [REDAKTUAR]

9 [REDAKTUAR]

10 [REDAKTUAR]

11 [REDAKTUAR]

12 [REDAKTUAR]

13 [REDAKTUAR]

14 [REDAKTUAR]

15 [REDAKTUAR]

16 Pë. Aty ka pas një epror, kush ka qenë -- se kanë ndryshuar  
17 eprorët aty, në atë zonë. Nuk më kujtohet për momentin kush ka  
18 qenë epror aty.

19 Py. Afërsisht, sa e madhe ka qenë njësia, pjesë e të cilit ai  
20 bënte?

21 Pë. Besoj ka pas 30-40 persona aty. Saktë nuk e di. Se  
22 thashë, numri anëtarëve ka ndërru, ka ndryshu. Por në momente  
23 të caktume, aty diku.

24 Py. E keni dëgjuar ndonjëherë për një person të quajtur

25 [REDAKTUAR]

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Fatmir Sopi (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493  
Pyetje të palës tjetër nga z. Von Bone Faqe 85  
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 Pë. Jo, nuk kam dëgjuar ndonjëherë për një person me emrin

2 [REDAKTUAR]

3 Py. Keni njohur ndonjëherë një njeri me emrin [REDAKTUAR]

4 Pë. Jo.

5 Py. Keni dëgjuar ndonjëherë për një person me emrin

6 [REDAKTUAR]

7 Pë. Jo, jo.

8 Py. A e keni dëgjuar ndonjëherë ndonjë person me emrin

9 [REDAKTUAR]

10 Pë. Jo. Sot po e dëgjoj. Jo.

11 Py. Faleminderit shumë. Keni dëgjuar ndonjëherë për një

12 person të quajtur Agron Xhemajli?

13 Pë. Po.

14 Py. Mund të na shpjegoni kush ishte?

15 Pë. Agron Xhemajli gjithashtu ka qenë pjesë e Ushtrisë

16 Çlirimtare të Kosovës.

17 Py. A bënte pjesë në Brigadën 153?

18 Pë. Po.

19 Py. Ku qëndronte, ku e kishte qendrën?

20 Pë. Agroni qëndronte në Zllash, në --. Ka qarkullu, nuk ka

21 qenë vetëm në të njëjtin vend. Zakonisht në Zllash.

22 Py. Ku në Zllash, ku tamam në Zllash? Për ku e keni fjalën?

23 Pë. Në Zllash në shtab, në njësi që kanë qenë në Zllash. Në

24 atë njësinë Buna 29 ndonjëherë. Nuk ka pas vendqëndrim të

25 përhershëm, diku.

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Fatmir Sopi (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493  
Pyetje të palës tjetër nga z. Von Bone Faqe 86  
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 Py. Kur flisni për shtab, ku ishte saktë kjo?

2 Pë. Kjo ishte, ku ka qëndruar shtabi i Brigadës 153, herë pas  
3 here ka qëndruar edhe ai.

4 Py. Thatë më herët se, shtabi i brigadës fillimisht ishte në  
5 shtëpinë tuaj, pastaj shkoi në shtëpinë e axhës, pastaj u  
6 zhvendos për në shkollë?

7 Pë. Po.

8 Py. Ky ishte vendi ku qëndronte Agron Xhemajli zakonisht?

9 Pë. Po, herë pas here.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Dua  
11 t'ju ndërpres një moment se dua të sqarohem unë.

12 Sapo thatë se shtabi ishte gjithashtu në shkollë, ishte  
13 edhe në shkollë, këtë keni dashur të thoni? Se unë më parë,  
14 dhe mund ta shikojmë sigurisht tekstin, unë e kuptova që ju  
15 thatë që shtabi nuk ka qenë në shkollë.

16 DËSHMITARI: Shtabi në asnjë periudhë nuk ka qenë i  
17 stacionuar në shkollë, por ka qenë në afërsi të shkollës. Aty  
18 ka qenë një zyrë e cila ashtë përdor për komandën e  
19 trajnimeve. Ka pas edhe një kuzhinë, e cila ka shërbyer për  
20 ushtarët.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
22 Faleminderit për sqarimin, sepse në faqen 58, në rreshtin 12  
23 deri në rreshtin 15, pyetja ishte:

24 "Më herët thatë se shtabi i brigadës fillimisht ishte në  
25 shtëpinë tuaj, pastaj kaloi në shtëpinë e axhës, pastaj kaloi

1 tek shkolla”?

2 Dhe ju u përgjigjët:

3 “Po”.

4 Tani e sqaruat dhe e bëtë më të qartë se cila ishte  
5 përgjigja juaj. Që të përputhet edhe me atë se çfarë keni  
6 thënë edhe sot paradite.

7 Zoti Avokat, mund të vazhdoni.

8 Z. VON BONE: [Përkthim]

9 Py. Pra ishte në një shtëpi pranë shkollës, për të qenë të  
10 saktë. Por e kujt ishte kjo shtëpi?

11 Pë. Ishte e axhës tim.

12 Py. Edhe kjo ishte shtëpia e axhës suaj? Më falni. Në një  
13 moment të caktuar, a e dinit ju që Agron Xhemajli ka qëndruar  
14 në kompleksin e Zllashit, d.m.th., atë vendin që familja  
15 Krasniqi kishte përdorur për të strehuar UÇK-në?

16 Pë. Nuk jam i sigurt. Unë nuk kam mund me përcjellë çdo  
17 lëvizje të askujt. Nuk jam i sigurt. Ka mund edhe të qëndrojë  
18 atje. Nuk e di.

19 Py. Për të qenë i saktë, ka pasur ndonjë detyrë të veçantë që  
20 i ishte ngarkuar, që e kishte Agron Xhemajli, brenda brigadës?

21 Pë. Nuk kam njohuri që ka pas detyrë të veçantë. Ka qenë  
22 ushtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në kuadër të Brigadës  
23 153. Për detyrën e tij, ma së miri e shpjegon ai vetë.

24 Py. E qartë.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zoti

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Fatmir Sopi (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493  
Pyetje të palës tjetër nga z. Von Bone Faqe 88  
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 Avokat, më lejoni të ndërpres.

2 Kemi nevojë që të vazhdojmë të jemi në seancë private?

3 Z. VON BONE: [Përkthim] Mendoj, po. Edhe për pak se jam i  
4 sigurt.

5 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në  
6 rregull.

7 Z. VON BONE: [Përkthim]

8 Py. A e dini nëse Agron Xhemajli kishte kompetencë, autoritet  
9 për të arrestuar njerëz apo për të marrë njerëz për t'i  
10 shoqëruar ata, për një arsye ose një tjetër?

11 Pë. Jo, nuk kam njohuri.

12 Py. Zoti Xhemajli, kishte ndonjë kompetencë, çfarë do, me  
13 cilësinë e tij si ushtar? Dua të them, a ishte ndonjë  
14 komandant njësie, ishte komandant i një zone të caktuar, apo  
15 ishte thjeshtë një ushtar i zakonshëm?

16 Pë. Jo. Nuk kam njohuri që ka qenë komandant i ndonjë njësie  
17 të caktuar.

18 Py. Faleminderit shumë. A keni dëgjuar ndonjëherë, a keni  
19 pasur kontakte ju vetë ndonjëherë me Agron Xhemajlin?

20 Pë. Po.

21 Py. Përse ishte ky kontakt?

22 Pë. Ai për një kohë ka qëndruar edhe në shtëpinë time.

23 Py. A keni dëgjuar ndonjëherë apo patët kontakt me Agron  
24 Xhemajlin lidhur me një urdhër që Agron Xhemajli [REDAKTUAR]  
25 [REDAKTUAR]



Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Fatmir Sopi (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493  
Pyetje të palës tjetër nga z. Von Bone Faqe 89  
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 [REDAKTUAR]

2 Pë. Jo. Kurrë nuk kam qenë në dijeni për atë punë.

3 Py. As pas lufte?

4 Pë. Nuk kam dëgjuar kurrë për atë punë.

5 Py. Faleminderit shumë.

6 Z. VON BONE: [Përkthim] Mund të kthehemi në seancë të  
7 hapur, të nderuar Gjykatës.

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
9 Faleminderit zoti Avokat.

10 Zonja Sekretare, të kalojmë në seancë publike, ju lutem.  
11 Prisni ju lutem.

12 [Seancë e hapur]

13 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,  
14 jemi në seancë publike.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mund  
16 të vazhdoni tani zoti Avokat.

17 Z. VON BONE: [Përkthim]

18 Py. Folëm sot më herët për Rrahman Dinin, thatë që e njihnit  
19 prej kohe.

20 A mund të më thoni ju lutem, ku ndodhej ai, ku strehohej  
21 ai gjatë periudhës mars-prill 1999?

22 Pë. Gjatë një kohe, ai ka qëndruar në shtëpinë time. Dhe në  
23 zyrat e shtabit, kur kemi kalu tek axha im. Ndërsa, saktë nuk  
24 më kujtohet kur, ai ka qëndruar në spital.

25 Py. Shtabi që ishte afër shkollës, aty ka qëndruar gjatë

- 1 kësaj periudhe, pra kur shtabi ndodhej në atë shtëpinë afër  
2 shkollës, a ju kujtohet se çfarë detyre kishte ai asokohe?
- 3 Pë. Nuk më kujtohet që ka pas ndonjë detyre. Nuk më kujtohet.
- 4 Py. Zoti Rrahman Dini, a kishte kompetencë për të disiplinuar  
5 njerëzit?
- 6 Pë. Jo. Nuk besoj që ka pas kompetencë, sepse nuk ka qenë në  
7 atë nivel që të japë urdhra ose kompetenca për disipline. Nuk  
8 kam njohuri.
- 9 Py. Ama ai bënte pjesë në komandën e Brigadës 153?
- 10 Pë. E vërtetë.
- 11 Py. Pse s' ishte ai në atë nivel, në atë pozitë që të  
12 ushtronte një kompetencë të tillë?
- 13 Pë. Gjendja e tij shëndetësore u keqësua dhe nuk po di tash.  
14 Aktiviteti i tij ka fillu veç të zbehet, në atë kuptim, se ka  
15 filluar t'i keqësohet gjendja shëndetësore.
- 16 Py. Keni pasur ndonjë kontakt kohët e fundit me familjen e  
17 Rrahman Dinit?
- 18 Pë. Jo. Kohët e fundit nuk i kam pa.
- 19 Py. A e dini nëse zoti Rrahman Dini ka mbajtur të burgosur  
20 njerëz gjatë periudhës mars-prill 1999?
- 21 Pë. Kurrë. Për këtë nuk kam pas dijeni, as nuk kam dijeni.
- 22 Py. Dhe po ju vetë, keni mbajtur ndonjëherë të burgosur gjatë  
23 periudhës mars-prill 1999?
- 24 Pë. Jo, në asnjë periudhe. As në mars, as në prill, as në  
25 qershor, as kurrë në jetën time.

1 Py. A dini gjë nëse ka pasur njerëz në zonën e Zllashit që

2 kanë qenë të burgosur, të mbajtur aty?

3 Pë. Jo, nuk di dhe jam i bindur që nuk ka pas.

4 Py. Nuk keni dëgjuar asnjëherë për ndonjë që të jetë ndaluar

5 aty?

6 Pë. Jo.

7 Py. A njihni ndonjë person me emrin Isa Kastrati?

8 Pë. Isa Kastrati? Po.

9 Py. Mund të na shpjegoni se kush është?

10 Pë. Ai ka qenë një ushtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës i

11 cili ka rënë dëshmor.

12 Py. Kur thoni që ka rënë dëshmor, çfarë doni të thoni tamam?

13 Pë. Është vrarë.

14 Py. A ju kujtohet se kur është vrarë?

15 Pë. Mund të jetë 21 ose 22 prill, afërsisht.

16 Py. A ju kujtohet se në ç'rrethana është vrarë?

17 Pë. Po, më kujtohet. Kam dëgjuar, ai i ka marrë dy të

18 plagosur në kohën kur kanë filluar me tërheq të plagosurit nga

19 regjioni i Zllashit në drejtim të zonës operative të Llapit,

20 për trajtim të mëtejshëm mjekësor. Ai e ka gabu rrugën, është

21 nda nga kolona dhe ka shkuar në drejtim të Bullajve, ku kanë

22 rënë së bashku me dy ushtarë të plagosur, ka rënë në pritë të

23 forcave serbe dhe janë vra.

24 Py. Ishte ushtar i UÇK-se, apo jo?

25 Pë. Po.

1 Py. Dhe ishte anëtar i Brigadës 153?

2 Pë. Jo. Ai ka qenë, në atë kohë ka pas kalu në zonën

3 operative të Karadakut.

4 Py. Çfarë do të thotë, që kaloi në një brigadë tjetër?

5 Pë. Po. Se ai fillimisht ka shërbyer në zonën operative të

6 Llapit, në cilën brigadë nuk më kujtohet, dhe prej atje ka

7 ardh në zonën...

8 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

9 Ndaloni ju lutem. Zoti Sopi, na duhet që të ndalojmë një

10 moment se kemi humbur lidhjen me zotin Mustafa. Ju kërkoj

11 ndjesë që ndërhyra kështu.

12 [Probleme teknike]

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zoti

14 Mustafa, më dëgjoni?

15 I AKUZUARI: [Video lidhje] Po. Tash po.

16 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] A

17 mund të më thoni se cila ishte gjëja e fundit?

18 I AKUZUARI: [Video lidhje] Gjëja e fundit që dëgjova,

19 ishte për Rrahman Dinin që ka fjetur diku afër, s'po e di

20 saktë se tani u ndërpre lidhja.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

22 Atëherë ta kontrolloj. Më duket se... Po kontrolloj se ku kemi

23 folur për këtë. Faqja 82.

24 Zoti Mustafa, cila ishte gjëja e fundit që dëgjuat për

25 zotin Rrahman Dini? Që kishte kompetencë për të disiplinuar

1 njerëz?

2 I AKUZUARI: [Video lidhje] Jo, jo. Atë s'e dëgjova, s'di.  
3 Unë fjalët e fundit që dëgjova ishte, që Agron Xhemajli ka  
4 fjet në shtëpinë e Fatmir Sopit, pastaj ku ka qenë shtabi i  
5 brigadës. Kështu diçka. Edhe Rrahman Dini që ka fjet afër aty  
6 në spital, a s'di qysh u përmend ajo punë.

7 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Faqja  
8 82, rreshti? Për cilën rresht sugjeroni?

9 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Mund të jetë rreshti 3, e  
10 nderuar Gjykatëse.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
12 Atëherë nuk është e qartë për faqen.

13 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Faqja 82, rreshti numër 3.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] "Për  
15 një farë kohe, nuk e di sa kohë qëndroi në spital".

16 Shumë mirë, zoti Avokat propozoj të ndjekim të njëjtën  
17 procedure si edhe me zotin Prokuror. Pra, lexoni se çfarë  
18 është thënë që ta dëgjojë edhe zoti Mustafa.

19 Z. VON BONE: [Përkthim] Po e lexoj.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Nëse  
21 preferoni që ta bëj unë, mund ta bëj.

22 Z. VON BONE: [Përkthim] Jo, nuk ka problem.

23 "Py. Pra në shtabin që është afër shkollës është që  
24 qëndroi ai dhe në atë periudhë kohore kur shtabi ndodhej në  
25 atë shtëpinë afër shkollës, a ju kujtohet se çfarë detyre

1 kishte asokohe?

2 "Pë. Nuk më kujtohet të ketë pasur ndonjë detyrë të

3 veçantë. Nuk më kujtohet.

4 "Py. Zoti Rrahman Dini, a kishte ndonjë kompetencë për të

5 disiplinuar njerëz?

6 "Pë. Nuk besoj. Nuk mendoj të ketë pasur një kompetencë

7 të tillë, sepse nuk ka qenë në atë nivel që të ishte në

8 gjendje të jepte urdhra të tillë, apo të disiplinonte

9 ushtarët. Nuk e di.

10 "Py. Ama ai ishte anëtar i komandës së Brigadës 153?"

11 "Pë. Po, ishte.

12 "Py. Atëherë pse nuk ishte në gjendje, në pozitë ai që të

13 ushtronte një kompetencë të tillë?

14 "Pë. Po shëndeti po i binte, u bë më pak aktiv, u zbeh në

15 aktivitet për shkak të gjendjes shëndetësore.

16 "Py. A keni ndonjë kontakt, patët ndonjë kontakt me

17 familjen e Rrahman Dinit?

18 "Pë. Jo. Kohët e fundit nuk e kam pa.

19 "Py. A dini gjë nëse zoti Rrahman Dini ka mbajtur të

20 burgosur njerëz në periudhën mars-prill '99?

21 "Pë. Jo, nuk kam pasur kurrë një njohuri të tillë.

22 "Py. Meqë jemi, ju vetë a keni mbajtur të burgosur, të

23 ndaluar njerëz gjatë periudhës mars-prill 1999?

24 "Pë. Jo, asnjëherë. Jo vetëm në mars-prill-maj -- pra as

25 në mars, prill maj, kurrë në jetë.

1 "Py. A keni dijeni nëse ka pasur njerëz në zonën e  
2 Zllashit që janë mbajtur të ndaluar, të burgosur?

3 "Pë. Jo, nuk kam dijeni. Jam i bindur që nuk ka pasur.

4 "Py. Nuk keni dëgjuar asnjëherë për askënd që të jetë  
5 mbajtur aty i ndaluar?

6 "Pë. Jo.

7 "Py. A e njihni një person me emrin Isa Kastrati?

8 "Pë. Isa Kastrati? Po.

9 "Py. Mund të na shpjegoni se kush është?

10 "Pë. Ai ishte ushtar i UÇK-së, i cili ra dëshmor.

11 "Py. Dhe kur thoni që, ra dëshmor, çfarë doni të thoni?

12 "Pë. E kanë vrarë, është vrarë.

13 "Py. E kuptova. Ju kujtohet se kur është vrarë?

14 "Pë. Mundet më datë 21 apo 22 prill, afërsisht.

15 "Py. A ju kujtohet se në ç'rrethana është vrarë?

16 "Pë. Po, më kujtohen rrethanat. Kam dëgjuar për këtë.

17 Mori dy të plagosur asokohe kur po e tërhiqnin njësinë, të

18 plagosurit asokohe kur po tërhiqnin njësinë për trajtim të

19 mëtejshëm mjekësor. Më falni. Dhe humbi rrugën. Mori dy të

20 plagosur --. Ju kërkoj ndjesë, po përpiqem ta ndjek.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

22 Rreshti 20.

23 Z. VON BONE: [Përkthim]

24 "Humbi rrugën, u nda nga autokolona dhe mori drejtimin e

25 Bullaj. Ku bashkë me dy ushtarët e plagosur ranë pritë e

1 forcave serbe. Kështu dhe janë vrarë.

2 "Py. Ishte ushtar i UÇK-së? E vërtetë?

3 "Pë. Po.

4 "Py. A bënte ai pjesë në Brigadën 153?

5 "Pë. Jo. Asokohe ai kishte kaluar në zonën operative të  
6 Karadakut.

7 "Py. Po çdo të thotë kjo, ka kaluar në një brigadë  
8 tjetër, apo çfarë?

9 "Pë. Po, sepse shërbente në zonën operative të Llapit në  
10 fillim, nuk e di me saktësi se në cilën brigadë. Por pastaj  
11 erdhi

12 Dhe këtu u ndërpre.

13 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Zoti  
14 Avokat, unë propozoj që të përsërisni pyetjen e fundit dhe  
15 kështu dëshmitari mund të fillojë përsëri me përgjigjen e asaj  
16 pyetje. Se ia ndërpreme, ia lamë përgjysmë.

17 "A kaloi në brigadë tjetër"?

18 Z. VON BONE: [Përkthim] Po.

19 Py. Zoti Sopi, pyetja ime është kjo, a kaloi në ndonjë  
20 brigadë tjetër?

21 Pë. Po, asokohe ai shërbente në kuadër të zonës operative të  
22 Karadakut.

23 Py. Mirë. Përpara se të kalonte në atë brigadë, a bënte pjesë  
24 në Brigadën 153?

25 Pë. Jo. Ai vetëm ka kaluar prej brigadave të Llapit, ku ka



1 qenë brigada 151 ose 152, nuk jam i sigurt, ka kaluar në zonën  
2 e vet. Sepse ai vjen prej regjionit të Karadakut dhe ka kaluar  
3 në zonën operative të Karadakut. Ashtu e di unë.

4 Py. Dua t'i kthehem pyetjes lidhur me mbajtjen si të ndaluar  
5 të njerëzve. A keni dëgjuar ndonjëherë nëse zona operative e  
6 Llapit kishte ndonjë qendër ndalimi?

7 Pë. Në periudhën e luftës nuk kam dëgjuar. Këtë e kam mësuar  
8 nga gjykimet që kanë ndodh pas luftës, ku komandanti i zonës  
9 operative të Llapit e ka pohuar një gjë të tillë. Ndërsa gjatë  
10 luftës nuk e kam dit se ka ekzistuar ajo.

11 Py. Gjatë periudhës që ju ndodheshit në Zllash, keni dëgjuar  
12 ndonjëherë ndonjë që të fliste se ka njerëz që mbahen të  
13 ndaluar në një qendër ndalimi?

14 Pë. Jo.

15 Py. A keni dëgjuar ndonjëherë për njerëz që kanë qenë të  
16 ndaluar në kompleksin e Zllashit?

17 Pë. Jo, nuk kam dëgjuar.

18 Py. A është diskutuar ndonjëherë një gjë e tillë në komandën  
19 e brigadës, pra në qoftë se ka pasur ndonjëherë njerëz të  
20 ndaluar në Zllash ose përreth Zllashit? A është diskutuar  
21 ndonjëherë kjo brenda brigadës tuaj, pra Brigadës 153?

22 Pë. Jo, asnjëherë.

23 Py. Sot, më parë, ju na treguat për dy ofensiva që kanë  
24 ndodhur. Njëra prej tyre ka ndodhur në datën 7 prill, edhe  
25 tjetra ka ndodhur në 18 shkurt, është e saktë kjo?

1 Pë. Prill. Prill edhe kjo në prill.

2 Py. Dua të flasim bashkë për ofensivën e parë. Personat e  
3 plagosur, ku u dërguan. D.m.th., a kishte ndonjë vend ku të  
4 plagosurit mund të dërgoheshin? E kam fjalën për Zllashin ose  
5 zonën për rreth Zllashit. Çfarë ndodhte me personat e  
6 plagosur?

7 Pë. Gjatë ofensivës së parë të 7 prillit, nuk kemi pas njerëz  
8 të plagosur.

9 Py. A mbeti ndonjë peron i vrarë në ofensivën e parë?

10 Pë. Jo.

11 Py. A kishte perona të sëmurë gjatë periudhës së ofensivës se  
12 parë?

13 Pë. Nuk më kujtohet, nuk di.

14 Py. Në cilin spital ka qëndruar Rrahman Dini?

15 Pë. Rrahman Dini ka qëndruar një kohë në spitalin ose në  
16 ambulancën ose në spitalin e improvizuar në Viti të Marecit.

17 Py. A jeni në dijeni se kur ka ndodhur kjo? Ka ndodhur pas  
18 ofensivës së dytë, përpara ofensivës së dytë? Kur ka ndodhur  
19 kjo?

20 Pë. Nuk jam i sigurt saktë kur ka ndodhur dhe sa ka ndejt  
21 aty, por e di se një kohe ka marrë trajtim mjekësor në atë  
22 ambulancë.

23 Py. A ka pasur ndonjë ambient në Brigadën 153 për personat që  
24 kishin nevojë për trajtim mjekësor? Kishte ndonjë ambient që  
25 përdorej për trajtim mjekësor?

1 Pë. Ajo ambulancë është përdor për shërbim mjekësor, ajo në  
2 Viti. Ndërsa pas ofensivës ashtë përdor edhe një shtëpi në  
3 afërsi të shkollës, në anën lindore të saj.

4 Py. Për çfarë ambulance e keni fjalën?

5 Pë. Në Marec e keni pyetjen?

6 Py. Po thonit për ambulancën, por thjesht po vrisja mendjen  
7 se çfarë është ambulanca? A kishte ndonjë ambient në Zllash ku  
8 njerëzit mund të trajtoheshin, në aspektin shëndetësor?

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

10 Avokat, a nuk foli ai për një shtëpi afër shkollës, në pjesën  
11 lindore? Kam përshtypjen se po e përsërisni pyetjen.

12 Z. VON BONE: [Përkthim] Këtë bëra, por u shpërqendrova  
13 pak nga përdorimi i fjalës ambulancë.

14 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Ju  
15 lutem, mos përsërisni pyetjen. Por bëni pyetje në lidhje me  
16 atë që nuk kuptuat.

17 Z. VON BONE: [Përkthim]

18 Py. A kishte ndonjë ambulancë në Zllash ose përrreth Zllashit  
19 për të transportuar njerëzit që kishin nevojë për kujdes  
20 shëndetësor?

21 Pë. Jo, ambulancë në kuptimin e transportit, jo. Unë mendova  
22 një shtëpi e cila shërbente si -- te ne në gjuhen shqipe,  
23 "ambulancë" i themi edhe asaj ku shkojnë për trajtim, për  
24 vaksina, injeksione, për trajtim. Në atë kuptim e përdora unë  
25 fjalën ambulancë, d.m.th., vend ku mund të qëndrojë i sëmuri.

1 Ka qenë një shtëpi në lindje të shkollës Zllash e cila  
2 për pronar ka pas Sahit Gashin.

3 Py. Si transportoheshin njerëzit në qoftë se kishin nevojë  
4 për përkujdesje mjekësore? Si është bërë kjo konkretisht gjatë  
5 kësaj periudhe?

6 Pë. Gjatë asaj periudhe, kur ka ndodh ndonjë i plagosur ose  
7 diçka prej vijës së frontit, është hequr prej shokëve të tijna  
8 që e kanë mbart me lese ose në mënyra të ndryshme që kanë mujt  
9 me e tërheq prej vijës. Ndërsa pjesa tjetër, është përdor  
10 veturat që kemi pas në dispozicion.

11 Py. Automjetet normale ushtarake apo çdo lloj automjeti  
12 tjetër që kishit në dispozicion?

13 Pë. Jo. Çdo mjet tjetër që kishim në dispozicion. Ne nuk kemi  
14 pas automjete ushtarake, apostafat ushtarake, në atë kuptimin  
15 mjete ushtarake.

16 Py. A keni ju njohuri në qoftë se ka pas ndonjë kontakt  
17 ndërmjet Adem Shehut dhe policisë ushtarake?

18 Pë. Nuk kam njohuri unë. Adem Shehu, ai ka qenë komandant  
19 brigade dhe ndoshta edhe ka pas kontakte ai, normal që ka pas  
20 kontakte me policinë ushtarake, me ushtarë, me të gjithë.  
21 Besoj që ka pas.

22 Py. Kur komanda e brigadës bënte mbledhje, drejtuesi i  
23 policisë ushtarake ishte gjithmonë në mbledhje të tilla?

24 Pë. Nuk më kujtohet, nuk më kujtohet një gjë e tillë.

25 Py. Ku qëndronte Adem Shehu, ku flinte, ku qëndronte ai?

1 Pë. Adem Shehu qëndronte aty ku qëndronte shtabi.

2 Py. Më herët folëm për shtabin që lëvizte. Po në atë kohë kur  
3 erdhi zoti Shehu ishte pak më vonë në kohë. Për çfarë shtabi e  
4 keni fjalën në këtë moment?

5 Pë. Në shtab të Brigadës 153.

6 Py. A doni të thoni që ishte afër asaj shtëpisë afër  
7 shkollës, apo ishte në një vend tjetër?

8 Pë. Po.

9 Py. Do të thuash në shtëpinë afër shkollës, apo jo?

10 Pë. Po, në shtëpinë afër shkollës. Ku ka qëndru shtabi, ka  
11 qëndru edhe komandanti i brigadës.

12 Py. Sa vetë qëndronin në atë shtëpi nga komanda?

13 Pë. Nuk më kujtohet, nuk di. Varësisht. Ne kemi pas detyra,  
14 nuk kemi qëndru vazhdimisht në komandë apo vend qëndrime. Unë  
15 për shembull, vazhdimisht kam qenë në lëvizje.

16 Py. Ju, nuk është se kishit takime të rregullta periodike së  
17 bashku me komandën e Brigadës 153? Si mund ta kuptoj këtë? Pra  
18 kishte ca periudha kur juve bënit mbledhje të zakonshme ose  
19 takoheshit rregullisht për të diskutuar për çështjet e kohës?

20 Pë. Jo, në atë kuptimin strikt. Kemi pas takime në bazë të  
21 zhvillimit të ngjarjeve.

22 Py. Sa shpesh ndodhnin takime të tilla?

23 Pë. Nuk më kujtohet.

24 Py. Këto takime gjithmonë mbaheshin në të njëjtin vend, apo  
25 mbaheshin në vende të ndryshme?

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Fatmir Sopi (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493  
Pyetje të palës tjetër nga z. Von Bone Faqe 102  
Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 Pë. Zakonisht, ku qëndronte shtabi, ndodhnin edhe takimet.

2 Py. A keni mbajtur juve ndonjë takim të shtabit në kompleksin  
3 në Zllash, të cilin e përmendëm pak më përpara dhe që ishin  
4 shtëpitë e familjes Krasniqi?

5 Pë. Nuk më kujtohet.

6 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

7 Avokat do të vazhdojmë deri ne orën 15:55.

8 Z. VON BONE: [Përkthim] Në rregull. Dua që të kalojmë në  
9 seancë private.

10 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.

11 Sekretare, ju lutem mund të kalojmë në seancë private?

12 ~~[Seancë private]~~[Seancë e hapur]

13 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar, jemi në  
14 seancë private.

15 Z. VON BONE: [Përkthim] Kërkoj seancë private sepse mund  
16 të përmend emra të përveçëm që nuk dua që të dëgjojen.

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Në  
18 rregull. Mund të vazhdoni.

19 Z. VON BONE: [Përkthim]

20 Py. Zoti Sopi, a e njihni dikë me emrin [REDAKTUAR]

21 Pë. [REDAKTUAR] mbiemër dhe ka shumë njerëz me mbiemër  
[REDAKTUAR]

22 Py. E kuptoj. A e njihni dikë me emrin [REDAKTUAR]

23 Pë. Jo.

24 [REDAKTUAR]

25 [REDAKTUAR]

Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Fatmir Sopi (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493

Pyetje të palës tjetër nga z. Von Bone

Page 103

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 [REDAKTUAR]

2 [REDAKTUAR]

3 [REDAKTUAR]

4 [REDAKTUAR]

5 [REDAKTUAR]

6 [REDAKTUAR]

7 [REDAKTUAR]

8 [REDAKTUAR]

9 [REDAKTUAR]

10 [REDAKTUAR]

11 [REDAKTUAR]

12 [REDAKTUAR]

13 [REDAKTUAR]

14 [REDAKTUAR]

15 [REDAKTUAR]

16 [REDAKTUAR]

17 [REDAKTUAR]

18 [REDAKTUAR]

19 [REDAKTUAR]

20 [REDAKTUAR]

21 Py. A ke dëgjuar ndonjëherë për dikë me emrin Alban Asllani?

22 Pë. Alban Asllani, po.

23 Py. A mund të më thoni se kush është ky person?

24 Pë. Ky ka qenë ushtar i Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës në

25 Brigadën 153.

- 1 Py. A të kujtohet se në cilën njësit ishte ai?
- 2 Pë. Ai ka qenë në njësitin e Prapashticës.
- 3 Py. Çfarë detyrash kishte ai?
- 4 Pë. Ushtar.
- 5 Py. A keni dijeni se kush ishte eprori i tij?
- 6 Pë. Momin Bajrami.
- 7 Py. Çfarë pozite kishte Mehmet Bajrami?
- 8 Pë. Momin Bajrami, jo Mehmet Bajrami.
- 9 Py. Momin, të kërkoj ndjesë. Ku ishte i stacionuar Momin
- 10 Bajrami?
- 11 Pë. Në fshatin e tij në Prapashticë.
- 12 Py. Sa larg është ky vend nga Zllashi?
- 13 Pë. Një orë e gjysmë.
- 14 Py. Sa larg është kjo nga Buna 29?
- 15 Pë. Një orë e ma tepër, gati 2 orë.
- 16 Py. Faleminderit.
- 17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Për
- 18 t'u sqaruar unë, dy orë në këmbë?
- 19 DËSHMITARI: Po, po. Flas në këmbë, gjithmonë.
- 20 Z. VON BONE: [Përkthim]
- 21 Py. A ke dëgjuar ndonjëherë për një person me emrin Shemi?
- 22 Pë. Jo.
- 23 Py. A mund të jetë nofkë kjo, Shemi?
- 24 Pë. Nuk e njoh, nuk po di.
- 25 Py. A njihni dikë me mbiemrin Shyti?



Dhomat e Specializuara të Kosovës - Gjykata Themelore

Dëshmitari: Fatmir Sopi (~~Seancë private~~) (Seancë e hapur) Riklasifikuar në bazë të F493

Pyetje të palës tjetër nga z. Von Bone

Page 105

Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107

1 Pë. Jo.

2 Py. A keni dëgjuar ndonjëherë për dikë me emrin Rabbit Aliu?

3 Pë. Po.

4 Py. A mund të na thoni se kush është ky person?

5 Pë. Ky person ka ardh prej zonës së Drenicës në brigadën tonë  
6 dhe ka qëndru aty deri në fund të luftës.

7 Py. Çfarë detyrash kishte ai?

8 Pë. Nuk ka pas ndonjë detyrë specifike.

9 Py. Ishte thjesht ushtar?

10 Pë. Po.

11 Py. Ai ishte pjesë e ndonjë batalioni të caktuar, konkret?

12 Pë. Nuk më kujtohet ku ka qenë saktë i vendosur, nuk më  
13 kujtohet. Vetëm si emër e kam njoft.

14 Py. Në rregull. A ju kujtohet se kur ka ardhur ai, kur është  
15 bërë ai pjesë e brigadës?

16 Pë. Saktë nuk më kujtohet, nuk më kujtohet. Ma vonë ka  
17 ardhur, nuk ka ardhur --. Nuk më kujtohet saktë.

18 Z. VON BONE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, mendoj se  
19 mund të kalojmë serish në seancë publike.

20 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Znj.  
21 Sekretare, ju lutem a mund të na ktheni në seancë publike?

22 [Seancë e hapur]

23 SEKRETARJA E GJYKATËS: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës,  
24 jemi sërish në seancë publike.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

1 Faleminderit Sekretare.

2 Ju lutem mund të vazhdoni zoti Avokat.

3 Z. VON BONE: [Përkthim]

4 Py. Zot Sopi, ju na shpjeguat se si realizohej komunikimi

5 përmes telefonit satelitor, përmes radiolidhjes ose

6 personalisht. Pra në çdonjërin prej këtyre mënyrave. Kur

7 përdorej lidhja me radio, a përdorej një shenjë thirrje?

8 Pë. Nuk më kujtohet. Ajo është përdor me shifra me siguri.

9 Por nuk më kujtohen saktë.

10 Py. A të kujtohet se cili ishte kodi ose cila ishte shenja e

11 thirrjes për brigadën?

12 Pë. Për brigadën ka qenë kodi i thirrjes, Buna.

13 Py. A të kujtohet se cili ka qenë kodi i thirrjes për shtabin

14 e zonës operative të Llapit?

15 Pë. Nëse jam mirë me kujtesën, Dardania.

16 Py. A keni pasur ju ndonjëherë kontakt me njësitin BIA përmes

17 radio lidhjes?

18 Pë. Nuk më kujtohet. Mund edhe të kem pas. Nuk më kujtohet.

19 Py. A keni dijeni nëse BIA kishte një kod thirrjeje?

20 Pë. Nuk më kujtohet.

21 Py. Faleminderit.

22 Z. VON BONE: [Përkthim] Të nderuar Gjykatës, mendoj që ky

23 është momenti i përshtatshëm për të përfunduar, sepse çdo temë

24 tjetër ose çdo pyetje tjetër që mund të kisha, do të ishte më

25 shumë se sa 5 minuta që kemi në dispozicion. Mendoj se është

Dëshmitari: Fatmir Sopi (Seancë e hapur)

Faqe 107

Pyetje të palës tjetër nga z. Von Bone

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107*

1 momenti i përshtatshëm për ta ndërprerë këtu.

2 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Shumë  
3 mirë.

4 Zoti Sopi, thuajse jemi në fund të ditës në gjykatë sot.

5 Do të vazhdojmë me dëshminë tuaj nesër në orën 9.30 të

6 mëngjesit. Shumë faleminderit për kohën sot dhe më lejoni t'ju

7 kujtoj se nuk duhet të diskutoni me askënd deri nesër në

8 mëngjes dëshminë tuaj të dhënë këtu në gjykatë. A e kuptoni

9 këtë?

10 DËSHMITARI: Po.

11 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Tani

12 do t'ju shoqërojë Sekretarja për të dalë nga salla. Mundohuni

13 që të pushoni dhe do të takohemi sërish nesër në mëngjes

14 bashkë.

15 DËSHMITARI: Faleminderit.

16 [Dëshmitari përfundon dëshminë]

17 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]

18 Faleminderit zonja Sekretare.

19 Z. VON BONE: [Përkthim] Nuk do të kemi shumë pyetje për

20 nesër sa i takon planifikimit të kohës.

21 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Më

22 lexuat mendjen.

23 Z. VON BONE: [Përkthim] Ndoshta një orë ose 40 minuta, jo

24 shumë. Por megjithatë varet nga lidhja me videolidhje.

1 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po ne  
2 nuk është se marrim parasysh le të themi problemet që mund të  
3 kemi me lidhjen, kur bëjmë llogaritjen e kohës që na duhet sa  
4 i takon pyetjeve të dëshmitarit.

5 A ka ndonjë gjë që ZPS-ja do të ngrejë me Trupin Gjykses  
6 në këtë pikë.

7 Z. MICHALCZUK: [Përkthim] Jo, nuk kemi asgjë për  
8 momentin, e nderuara Gjykatëse.

9 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Po  
10 Avokatja e Viktimave?

11 ZNJ. PUES: [Përkthim] Jo. Vetëm një sugjerim të vogël. Në  
12 qoftë se do të vazhdojnë problemet me internetin, ndoshta do  
13 të ishte me vlerë që të akuzuarin ta kishim të pranishëm në  
14 sallë. Dhe kjo ndoshta do t'i zgjidhte problemet.

15 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim]  
16 Faleminderit zonja Avokate e Viktimave.

17 Ky është një opsion që e kemi marrë në shqyrtim dhe kur  
18 të këtë arsye të arsyeshme, sigurisht që do ta bëjmë këtë gjë.  
19 Do ta lemë për momentin siç kemi rënë dakord. Megjithatë, në  
20 qoftë se do të vazhdojë që të kemi probleme me lidhjen,  
21 atëherë do t'i kërkojmë zotit Mustafa që të vijë këtu.

22 Zoti Avokat, a dëshironi të ngrini ndonjë çështje për  
23 Trupin Gjykses?

24 Z. VON BONE: [Përkthim] Jo, të nderuar Gjykatës.

25 KRYETARJA E TRUPIT GJYKUES VELDT-FOGLIA: [Përkthim] Mirë

*Të gjitha redaktimet janë bërë në bazë të Urdhrave F493, F509 dhe CRSPD107*

1 atëherë, e përfundojmë këtu sot. Do ta fillojmë seancën nesër  
2 në mëngjes. Do dua të falënderoj palët. Dua të falënderoj  
3 përkthyesit, stenografët gjithashtu edhe teknikët audiovizivë,  
4 dhe personelit të sigurisë për ndihmën e ditës së sotme.

5 Do ta vijojmë seancën nesër në mëngjes, në orën 9.30.

6 Faleminderit.

7 --- Seanca mbyllet në orën 15.55

8

9

10

11

12

13

14

15

16

17

18

19

20

21

22

23

24

25